



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

R A P O R T

Për

Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2013

Tiranë, Shkurt 2014



PËRMBAJTJA

	Faqe
A. PËRGATITJA, ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I PROCESIT DERI DITËN E ZGJEDHJEVE	
A.1 Akte të KOZ-së	6
A.2 Projektet pilot SEN dhe SEV	8
A.3 Regjistrimi i subjekteve zgjedhore	16
A.4 Fleta e Votimit	18
A.5 Infrastruktura zgjedhore	19
A.5.1 Ngritja e Zyrave Rajonale Zgjedhore	19
A.5.2 Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve	21
A.5.3 Ngritja dhe funksionimi i KOV-ve	24
A.5.4 Ngritja dhe funksionimi i GNV-ve	26
A.5.5 Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë	27
A.6 Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve, KOV-ve dhe GNV-ve	29
A.6.1 Përgatitja e programit të trajnimit	29
A.6.2 Zhvillimi i trajnimit	31
A.7 Edukimi zgjedhor i shtetasve	34
A.8 Monitorimi i fushatës zgjedhore dhe vëzhgimi i procesit	36
A.8.1 Ngritja dhe funksionimi i Bordit të Monitorimit të Medias	36
A.8.2 Regjistrimi i vëzhguesve vendas dhe të huaj	38
A.9 Përgatitja dhe dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe dokumentacionit zgjedhor nga KOZ në KZAZ dhe nga KZAZ në KOV	39
B. PROCESI I VOTIMIT, NUMËRIMI DHE SHPALLJA E REZULTATIT	
B.1 Dita e zgjedhjeve	40
B.2 Dorëzimi i materialit zgjedhor në KZAZ-të, pas mbylljes së QV-së. Procesi i numërimit në VNV dhe nxjerrja e rezultatit nga KZAZ-të	44
B.3 Publikimi i rezultatit paraprak dhe nxjerrja e rezultatit nga KOZ	46
B.4 Raste të shkeljeve të dispozitave të Kodit Zgjedhor	48
B.4.1 Shkeljet nga personat e ngarkuar me detyra (kryetar bashkie/komune)	48



B.4.2	Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal nga komisionerët e niveleve të dyta dhe të treta	50
B.4.3	Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga subjektet zgjedhore	51
C.	ANKIMET NË RRUGË ADMINISTRATIVE DHE NË KOLEGJIN ZGJEDHOR	
C.1	Ankimet zgjedhore në KQZ	51
C.2	Ankimet kundër vendimeve të KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor	53
C.2.1	Ankimet para zgjedhore të paraqitura në Kolegjin Zgjedhor	53
C.2.2	Ankimet pas zgjedhore të paraqitura në Kolegjin Zgjedhor	54
D.	SHPLLJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE	56
E.	BUXHETI PËR ZGJEDHJET, FINANCIMI DHE AUDITIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE	
E.1	Buxheti i KQZ për zgjedhjet	57
E.2	Financimi dhe auditimi i subjekteve zgjedhore në zgjedhje	59
F.	ZGJEDHJET E PJESSHME	
F.1	Zgjedhje e pjesshme për kryetar të organeve të qeverisjes vendore të datës 23.06.2013	65
F.2	Zgjedhje e pjesshme për kryetar të organeve të qeverisjes vendore të datës 01.09.2013	66
F.3	Zgjedhje e pjesshme për kryetar të organeve të qeverisjes vendore të datës 03.11.2013	67
G	TRANSPARENCA E VEPRIMTRISË SË KQZ-SË	69
H	VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË	
H.1	Burimet Njerëzore në KQZ	69
H.2	Buxheti i KQZ-së për vitin 2013	72
H.3	Raportet financiare vjetore të Partive Politike për vitin 2013	73
I	BASHKËPUNIMI I KQZ-SË ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË	74



I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar Deputetë,

Si kryetare e KOZ-së, kam kënaqësinë dhe privilegjin që të paraqes para Jush raportin e punës së institucionit të KOZ-së për vitin 2013, një vit tejet i ngarkuar pasi përkon me zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend të kësaj legjislature, por edhe administrimin e disa proceseve të pjesshme zgjedhore, organizimi dhe administrimi i të cilëve evidenton qartësisht dhe në detaje veprimtarinë e institucionit në përmbushje të rolit dhe misionit të tij, caktuar nga ligji zgjedhor. Në këtë kontekst, përmbajtja dhe analiza e këtij raporti bazohet kryesisht në ecurinë e këtyre proceseve zgjedhore, por sigurisht edhe në aktivitetin dhe veprimtarinë funksionale të KOZ-së.

Për Trupën e KOZ-së, viti 2013 ka qenë sfidues në përmbushjen e misionit themelor dhe detyrimeve ligjore për të cilat ajo është zgjedhur, votuar dhe mandatuar. Funksionimi i pjesshëm, vetëm me katër anëtarë, ka qenë dhe vazhdon të jetë një ngërç institucional, para të cilit nuk është gjendur asnjëherë KOZ. Pavarësisht kësaj, KOZ dhe administrata zgjedhore arriti të realizojë një proces zgjedhor, i cili u çertifikua edhe nga misionet e monitorimit vendase dhe të huaja. Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR vlerësoi se *"zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit ishin konkurruese me pjesëmarrje aktive të qytetarëve gjatë gjithë fushatës dhe respekt të mirëfilltë për liritë themelore"*.

KOZ, falë punës së bazuar në profesionalizëm, integritet dhe transparencë, edhe pse pjesa më e madhe e organizimit dhe administrimit të procesit u krye në përbërje jo të plotë të anëtarësisë së saj, mbështetur dhe në asistencën dhe kontributin permanent të partnerëve ndërkombëtarë, së bashku me aktorët e tjerë vendas, ja dolën mbanë të zhvillojnë një proces zgjedhor, i cili u vlerësua për pajtueshmërinë e tij me standardet e OSBE dhe ato ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas.

Raporti i veprimtarisë së institucionit për vitin 2013, është analitik dhe pasqyrues, dhe është strukturuar në rubrika sipas kronologjisë së etapave në të cilat një proces zgjedhor kalon. Raporti pasqyron krahas realizimeve dhe arritjeve, edhe problematikat, duke fokusuar çështje që lidhen me ecurinë e punës së KOZ-së, debatin dhe vendimmarrjen e saj, të cilat janë elementët kryesorë të funksionimit të një procesi zgjedhor, si për caktimin e numrit të zonave të administrimit zgjedhor, caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore, pamundësinë e plotësimit të të gjithë kuadrit nënligjor normues, dhe veçanërisht për aplikimin e teknologjisë së informacionit me anë të dy projekteve pilot SEN dhe SEV.

Duke mirëpritur vlerësimin dhe rekomandimet Tuaja për veprimtarinë në vijim, KOZ në mënyrë të pakushtëzuar mbetet i angazhuar për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor, të drejtën kushtetuese të votës, lirinë dhe barazinë e saj!

Ju faleminderit!



A. PËRGATITJA, ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I PROCESIT DERI DITËN E ZGJEDHJEVE

A.1 AKTE TË KOZ-SË:

Pas shpalljes së Dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvend, si dhe në zbatim të vendimit nr.17, datë 06.12.2012 "Për miratimin e Planit Orientues të Veprimeve të KOZ-së për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013", i cili shërbeu si një kornizë udhëzuese për veprimet dhe aktet nënligjore, KOZ miratoi për këto zgjedhje 742 akte (udhëzime dhe vendime). Diskutimi dhe miratimi në seanca publike i akteve nënligjore në KOZ, ka patur edhe kontributin e subjekteve zgjedhore, të cilat, nëpërmjet propozimeve konkrete kanë ndikuar në cilësinë e akteve të miratuara.

Në mbështetje të nenit 24 të Kodit Zgjedhor, KOZ duhet të miratonte aktet me karakter normativ jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve. Ky detyrim ligjor u përmbush për pjesën më të madhe të akteve normuese, duke miratuar udhëzime të nevojshme si rrjedhojë e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, si dhe duke bërë ndryshimet përkatëse në udhëzimet në fuqi të vitit 2009. Këto akte nënligjore ishin të qarta dhe rregullonin në përgjithësi, marrëdhëniet në lidhje me organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin. Largimi i tre anëtarëve të KOZ si pasojë e dorëheqjes së tyre nga detyra e anëtarit të KOZ-së, bëri që një pjesë e udhëzimeve të planifikuara në planin e veprimeve të mos miratoheshin.


Udhëzimet dhe Aktet normuese të KOZ-së kanë rregulluar marrëdhënie të tilla, si:

- Organizimin dhe Funksionimin e Zyrave Rajonale Zgjedhore, Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, Komisionit të Qendrës së Votimit dhe Grupit të Numërimit;
- Detyrat e Policisë së Shtetit në zgjedhje;
- Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KOZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV;
- Për unifikimin e praktikave të vlerësimit të fletëve të votimit nga personat e ngarkuar nga Kodi Zgjedhor, për numërimin dhe vlerësimin e votave;
- Kriteret për emërimin e ekspertëve kontabël;
- Akreditimin e vëshguesve të partive politike dhe të organizatave jofitimprurëse vendase dhe të huaja;
- Vendndodhjen e VNV dhe vendndodhjen e numërimit e Qendrave të Votimit;
- Administrimin e materialeve zgjedhore;



- Verifikimin e dokumentacionit të kandidimit;
- Rregullat për afishimin e materialeve propagandistike;
- Procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e mandatit të fundit midis subjekteve zgjedhore që kanë herës të njëjtë dhe numër të barabartë votash;
- Kriteret për caktimin e numrit dhe të vendndodhjes së qendrave të votimit;
- Kriteret për emërimin dhe detyrat e auditëve teknikien.

Për sa i përket vendimmarrjes në tërësi për vitin 2013, KOZ ka miratuar gjithsej **853** akte nënligjore, nga të cilat **733** vendime për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013. Numri i vendimeve të miratuara me përbërjen e plotë të KOZ-së deri më datë 17.04.2013 është **197** dhe **656** vendime janë miratuar gjatë kohës së funksionimit të KOZ-se me 4 anëtarë.



Në raport me objektin e këtyre vendimeve, pjesa më e madhe e tyre ka shërbyer për:

- Regjistrimin e subjekteve zgjedhore në KOZ (regjistrimin e partive politike, kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit dhe listave shumemërore);
- Miratimin e modeleve të kandidimit;
- Miratimin e dokumentacionit të punës të komisioneve të niveleve të dyta e të treta;
- Miratimin e manualeve zgjedhore;
- Emërimet dhe zëvendësime të komisionerëve zgjedhorë;
- Miratimin e modeleve të materialeve zgjedhore;
- Miratimin e marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit;
- Miratimin e vëzhguesve vendorë apo të huaj;
- Aplikimi i Sistemit SEN dhe SEV;
- Marrjen e masave administrative në raste të caktuara (vendosja e sanksioneve administrative ndaj disa kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore dhe ndaj disa partive politike, të cilat nuk respektojnë kriterin e gjinisë në listat shumemërore);
- Kallzimet penale ndaj komisionerëve/kryetarëve të njësive vendore si pasojë e konsumimit të veprave penale gjatë ushtrimit të detyrave të tyre;



- Miratimet për nxjerrjen e rezultatit të dymbëdhjetë zonave zgjedhore;
- Vendime për kërkesat ankimore;
- Vendime për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme;
- Zëvendësim të mandatit të deputetit, pas njoftimit të vakancave nga Kuvendi i Shqipërisë.

KQZ nuk arriti të bënte shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor, për shkak të mungesës së shumicës së cilësuar prej 5 anëtarësh të KQZ-së në mbledhjen e thirrur me rend dite për shpërndarjen e mandateve për zonat zgjedhore.

A.2 PROJEKTET PILOT SEN DHE SEV:

Dy projektet pilot SEN (Sistemi Elektronik i Numërimit) dhe SEV (Sistemi Elektronik i Verifikimit) të cilat kishin për qëllim testimin e aplikimit të teknologjisë së informacionit në qarkun e Tiranës (për SEV) dhe qarkun e Fierit (për SEN) morën gjithë impenjimin e Institucionit të KQZ-së për realizimin dhe zhvillimin e tyre. Hapat e para për aplikimin e këtyre dy projekteve janë raportuar edhe në raportin e institucionit për vitin 2012, por për specifikën dhe rëndësinë e tyre, po prezantojmë një panoramë të përmblodhur dhe të qartë të punës që nga pikënisja e saj, e cila daton në shtator 2012:

Në muajin shtator 2012, KQZ hartoi një plan veprimi për përgatitjen e dokumentacionit për dy projektet pilot të parashikuara në Kodin Zgjedhor, që bazohen në përdorimin e teknologjisë së informacionit për zgjedhjet 2013, atë të sistemit elektronik të numërimit (SEN) dhe sistemit elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve ditën e votimit (SEV). Deri në datën 18 tetor 2012 u përgatitën kërkesat bazë për hartimin e detyrës së projektim-zbatimit për të dy projektet, SEN dhe SEV.

Në planin e veprimit për implementimin e këtyre 2 projekteve, të hartuar në bazë të dispozitave të veçanta të Kodit Zgjedhor dhe të harmonizuar me legjislacionin për prokurimet publike, u parashikua që specifikimet teknike do të bëheshin nga një kompani e specializuar. Referuar kohës së limituar në dispozicion për përgatitjen e këtyre specifikimeve (vetëm procedura e prokurimit "shërbim konsulence" për projektet teknike kërkonte minimuni 60 ditë), pasi u dëgjuan dhe u diskutuan nga KQZ kërkesat bazë për të dy projektet, u pa e arsyeshme që administrata e KQZ-së



të përgatiste edhe dokumentacionin teknik, duke synuar të shkohej në një projekt-buxhet.

Në rrugë zyrtare, KQZ i kërkoi Kryeministrisë dhe Ministrisë së Brendshme caktimin e ekspertëve që do të jepnin konsulencë teknike për projektet, ashtu siç parashikon Kodi Zgjedhor.

Në fillim të muajit nëntor 2012, administrata e KQZ-së përgatiti dhe paraqiti në mbledhje informale të KQZ-së specifikimet teknike dhe projekt-buxhetin për të dy projektet. Pas diskutimesh të vazhdueshme të grupeve teknike të punës u konkludua që në dhjetor 2012 të saktësohej i gjithë dokumentacioni i nevojshëm teknik për të dy projektet, duke përfshirë edhe llojin e çertifikatave që duheshin kërkuar, si për kompanitë garuese, ashtu dhe për vetë sistemet që do të zbatoheshin. Hartimi i dokumentacionit përkatës mori vëmendjen e mbledhjeve të herëpashershme të KQZ-së, dhe në fund të muajit dhjetor, me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të partive politike, KQZ me Vendim Nr.23, datë 28.12.2012, miratoi procedurën prokuroese që do të përdorej për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizonin projektet teknologjike SEN dhe SEV. Mbështetur në përcaktimet e ligjit për prokurimin publik, në kushtet e një kohe të kufizuar, KQZ vendosi të përdorë "procedurë me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës".

Për të garantuar transparencën, me qëllim pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve që veprojnë në këtë fushë, njoftimi për zhvillimin e këtyre procedurave iu adresua jo vetëm kompanive që kishin shprehur zyrtarisht interes pranë KQZ-së, por u botua në 4 gazeta vendase dhe në median ndërkombëtare. Puna për përzgjedhjen e kompanive për shkak të rëndësisë së procesit mori kohën e nevojshme ashtu siç përcaktohet në ligjin për prokurimin publik.

Në përfundim të procedurave prokuroese u përzgjedh për zbatimin e të dy projekteve pilot shoqëria spanjolle "INDRA".

Në përfundim të negociatave ndërmjet Shoqërisë "INDRA" dhe grupit të punës së KQZ-së, u lidhën kontratat me nr.26/22, datë 16.03.2013, dhe nr. nr.25/29, datë 25.03.2013 përkatësisht për projektin pilot SEN dhe SEV.



Kodi Zgjedhor në nenin 179/1 parashikon se procedurat e prokurimit duhet të kishin përfunduar jo më vonë se 6 muaj para datës së zgjedhjeve, pra më 23 dhjetor 2013. Konstituimi me vonesë i KQZ-së dhe në të njëjtën kohë, detyrimi ligjor për respektimin e procedurave të prokurimit publik (megjithë përzgjedhjen e procedurës pa shpallje, me negociim – e cila kërkonte më pak kohë) çuan në tejkalim prej më shumë se dy muaj nga afati ligjor. Megjithatë, KQZ ndërmori të gjitha masat që në veprimet e etapave vijuese të tejkaloheshin këto vonesa.

Pas nënshkrimit të kontratave, KQZ miratoi planet e veprimit për përmbushjen e projekteve pilot SEN dhe SEV.

Zhvillimet për projektin SEN:

Më datën 13.04.2013 u bë testimi i parë i projektit SEN në Tiranë. Ky testim i përgjithshëm u planifikua dhe realizua në kushte të përafërta, fizike dhe teknike, me specifikat e infrastrukturës zgjedhore të qarkut Fier. Testimi u krye me një fletë votimi "tip", e orientuar "vertikal" me 42 subjekte të renditura, të prodhuar nga vetë kompania "INDRA", sipas specifikimeve të miratuara nga KQZ me vendimin nr. 23, datë 05.02.2013 "Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin 2013" dhe me vendimin nr. 175, datë 08.03.2013 "Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të fletëve të votimit, për zonën zgjedhore Qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013".

Tesimi i zhvilluar në transparencë të plotë, në prezencë të subjekteve zgjedhore, partnerëve ndërkombëtarë, përfaqësuesve të OSBE/ODIHR-it dhe medias, megjithë ndonjë aspekt teknik të evidentuar, përgjithësisht, plotësoi pritshmëritë e përcaktuara në Kodin Zgjedhor për këtë proces.

Pamundësia e parashikimit të saktë të numrit të subjekteve zgjedhore që do të garonin në zgjedhjet e 23 qershorit 2013, e detyroi administratën e KQZ-së që të paraqiste për miratim në mbledhje të KQZ-së, dy modele të fletës së votimit: një në orientim "vertikal", e cila mund të përmbante deri në 42 subjekte zgjedhore dhe tjetra në orientim "horizontal", e cila mund të përmbante deri në 66 subjekte. KQZ solli në vëmendje pritshmërinë për një numër të madh subjektësh zgjedhore garuese, nisur nga historiku i këtij numri në zgjedhjet pararendëse, por në vlerësim të insistimit të partive politike, miratoi modelin e fletës së votimit me orientim "vertikal".



Grupi i punës, i cili kryente negociatat, theksoi faktin se shoqëria "INDRA", menjëherë pas miratimit të modelit dhe specifikimeve teknike të fletës së votimit do të fillonte me përgatitjen e programimit të Sistemit Elektronik të Numërimit dhe leximin e fletës së votimit, të cilat kishin rëndësinë thelbësore për realizimin e projektit. Pas kësaj procedure ashtu sikundër ishte pasqyruar edhe në kontratë, modeli dhe specifikimet e fletës së votimit për zonën zgjedhore Qarku Fier, nuk mund te ndryshonin më. Modifikimi i tyre përbënte ndryshim të kushteve thelbësore të kontratës dhe shoqëria do të kërkonte zgjidhjen e parakohshme të saj. Edhe pas këtij konstatimi nga Grupi i Punës, përfaqësuesit e partive politike në KQZ, deklaruan me forcë se nëse KQZ do të pranonte ndryshim të orientimit të fletës së votimit nga "vertikal" në orientim "horizontal", zgjedhësit për shkak të traditës së votimit, të mësuar me fletë të tipit "vertikal" do të konfondohehin, dhe vullneti i tyre mund të shtrembërohej. Shprehja e saktë e vullnetit të zgjedhësve u vlerësua parësore.

Në përfundim të procesit të paraqitjes së listave shumemërore nga partitë politike, koalicioneve dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit rezultoi se numri i tyre ishte më i madh se në zgjedhjet e kaluara (66 subjekte zgjedhore dhe në dy zona zgjedhore Qarku Fier dhe Vlorë kishte edhe një kandidat të mbështetur nga zgjedhësit). Me insistimin e KQZ-së në rrethanat konkrete të krijuara, kompania "INDRA" me shkresën nr.26/29 prot, datë 07.05.2013, pranoi alternativën për fletë votimi me 66 subjekte të listuara, të bazuar në dizenjimin e fletës së votimit me orientim "horizontal". Megjithatë, kompania "INDRA", e kushtëzoi pranimin e kësaj alternative me miratimin nga KQZ të modelit të fletës së votimit për Zonën Zgjedhore Qarku Fier detyrimisht deri më datë 8 maj 2013, veprim i cili ishte e pamundur pasi procesi i miratimit të listave shumemërore përfundonte më datë 14 maj – sipas afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Numri shumë i madh i subjekteve zgjedhore të regjistruara, detyroi KQZ-në që me vendimin nr.446, datë 20.05.2013 "Për disa ndryshime në vendimin e KQZ-së nr. 23, datë 05.02.2013" të ndryshonte disa specifikime të modelit të fletës së votimit për t'u përshtatur me numrin e subjekteve zgjedhore që do të merrnin pjesë në zgjedhje. Në kushtet e krijuara, u vazhduan negociatat me shoqërinë "INDRA", duke i kërkuar mundësinë e modifikimit të programeve, sipas ndryshimeve të bëra në specifikimet teknike të fletës së votimit të miratuar nga KQZ me vendimin nr.446, datë 20.05.2013 "Për disa ndryshime në vendimin e KQZ-së nr. 23, datë 05.02.2013".



Kompania "INDRA", më datë 30 Maj theksoi faktin se nuk kishte kohë të mjaftueshme për të implementuar këtë programim në sistemin e numërimit elektronik dhe zhvillimin e veprimtarive logjistike të lidhura me procesin. Gjithashtu, kompania deklaronte se ishte para gjendjes së përfundimit të parakohshëm të kontratës, sipas përcaktimeve të pikës 9 të kontratës.

Në pikën 9 të kontratës për projektin SEN, në Rubrikën "Zgjidhja e kontratës", germa "d" dhe "e" ishte përcaktuar që:

"d. Në rastin kur KQZ modifikon në mënyrë thelbësore kushtet teknike të kontratës, Indra do mund të përfundojë këtë kontratë me efekt të menjëhershëm, pa pasur asnjë lloj përgjegjësie. KQZ do t'i paguajë Indrës të gjitha shpenzimet e kryera nga kompania, deri në datën e përfundimit".

"e. Modifikimi i dizenjës së fletës do të kuptohet si ndryshim thelbësor i kontratës kur, përfshihet kërkesa për të inkorporuar/shtuar më shumë parti/subjekte se maksimumi për të cilën është dizenuar (42), apo ndryshimin e orientimit të saj (vertikal), etj,".

Ndryshimet e specifikimeve të fletës së votimit ku më kryesorja ishte gjatësia e fletës së votimit, përbënte ndryshim thelbësor të kushteve të kontratës, dhe në kohën kur ishim vetëm 6 ditë përpara datës së testimit të dytë të sistemit (sipas planit të veprimeve), shoqëria INDRA nuk mund të përshtaste në Sistemin Elektronik të Numërimit dhe programimet përkatëse me ndryshimet e madhësisë së fletës së votimit. Në këto kushte, kontrata me Shoqërinë "INDRA" me objekt realizimin e projektit të Sistemit Elektronik të Numërimit në Zonën Zgjedhore Qarku Fier, në mbështetje të pikës 9, germa "d" dhe "e" të saj përfundonte në mënyrë të parakohshme.

Për këto arsye KQZ, mbështetur në nenin 21/2, pika 3, në shtojcën II, seksioni 3, pika 2, të Kodit Zgjedhor, me Vendim Nr.576, datë 18.06.2013, vendosi numërimin me dorë të votave në Zonën Zgjedhore, Qarku Fier në zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013.

Zhvillimet për projektin SEV:

KQZ në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe përcaktimeve kontraktuale, zhvilloi më datë 17 maj dhe 8 Qershor 2013 dy prova për testimin e sistemit elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të pjesëmarrjes së zgjedhësve ditën e



votimit (SEV). Provat u zhvilluan në ambientet e KOZ-së, simuluan votimin, procesin e transmetimit të të dhënave dhe procesin e kopjimit/hedhjes së të dhënave në Sistemin Qendror në dy Qendra Votimi.

Prova u krye në transparencë të plotë, në prezencë të përfaqësuesve të partive politike, partnerëve ndërkombëtarë, përfaqësuesve të OSBE/ODIHR-it, medias, si dhe auditëve teknikienë të KOZ-së, të cilët në mbështetje të seksionit 4, pika 4 të Shtojcës III të Kodit Zgjedhor kishin për detyrë kryerjen e auditimit dhe raportimit të sigurisë dhe funksionalitetit të sistemit.

Në përfundim të zhvillimit të testit për vlerësimin e sigurisë dhe funksionimit të sistemit elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve, auditët teknikien të KOZ-së dhe specialistët teknik të subjekteve zgjedhore raportuan problematikat e mëposhtme:

1. Sistemi i testuar më datë 8 qershor realizoi pjesërisht vetëm disa kërkesa bazë të përcaktuara në shtojcën III të Kodit Zgjedhor. Qëllimi bazë i zbatimit të këtij sistemi ishte verifikimi dhe regjistrimi i pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e votimit, nëpërmjet leximit të dokumentit identifikues biometrik. Sistemi tregoi se për shkak të dëmtimit në një masë të konsiderueshme të kartës së identitetit të zgjedhësve, verifikimi dhe regjistrimi elektronik i zgjedhësve do të gjenerojë të dhëna për pjesëmarrjen e zgjedhësve në ditën e votimit jo reale, të pasakta (rreth 11% e dokumentave nuk u lexuan). Sipas nenit 105 dhe Seksionit 5 të Shtojcës III, të Kodit Zgjedhor zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve. Gjatë testimit të SEV rezultoi se një pjesë e dokumenteve të identitetit nuk u lexuan dhe sistemi nuk gjeneronte një të dhënë me numrin e saktë të dokumenteve të palexuara. Në këtë rast, zgjedhësi, të cilit SEV nuk ia lexonte dokumentin e identitetit, votonte duke nënshkruar në listën e zgjedhësve. Për këtë shkak, në përfundim të votimit rezultuan të dhëna të ndryshme për numrin e zgjedhësve që kishin votuar sipas nënshkrimeve dhe sipas raporteve të SEV. Sipas përcaktimeve të neneve 113, 116, 116/1, 119, 120, 122, 123, nxjerrja e rezultatit bazohet ndër të tjera edhe në një element të rëndësishëm, siç është numri i zgjedhësve që kanë votuar. Nxjerrja e të dhënave jo reale për numrin e zgjedhësve që do të merrnin pjesë në votime në Qendrat e Votimit në Qarkun e Tiranës do të sillte vonesa, bllokime dhe mosrakordim të shifrave në rubrikat e tabelave të rezultateve, pra si rrjedhim, përshtjellim në procedurat e numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit.



2. Testimi i SEV nuk arriti të përcaktojë orën e “hapjes” dhe “mbylljes” së sistemit, një element i cili shërben për të vërtetuar së pari vlefshmërinë e procesit të zgjedhjeve në qendrën e votimit (në rast se në një QV nuk ka filluar procesi apo nuk është votuar më shumë se 5 orë, sipas përcaktimeve të nenit 160, pika 1/c) dhe së dyti, respektimin e orarit të votimit në qendrën e votimit, sipas përcaktimit të nenit 11 të Kodit Zgjedhor.

3. Procedurat e ndjekura gjatë testimit, dëshmuuan vonesa të theksuara në procesin e votimit. Kjo për shkak se përveç procedurave të parashikuara për paraqitjen dhe verifikimin e zgjedhësit në qendrën e votimit, shtohet edhe elementi i verifikimit elektronik të dokumentit të identifikimit.
Në këtë aspekt, vlen për t’u konsideruar fakti se një pjesë e dokumenteve të identitetit (rreth 11%) ishin të palexueshme nga sistemi, veprim që merrte kohë të shtuar në proces dhe sillte konfuzion në vendimarrjen e KQV-së.
Nisur nga të dhënat e pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e votimit në qendrat e votimit të Qarkut Tiranë, numri i zgjedhësve parashikohej të ishte relativisht i lartë. Pavarësisht se numri i zgjedhësve për Qendër Votimi nuk do të ishte më i madh se 700, zbatimi i SEV-it me problematikat e sipër dëshmuara do të reflektonte radhë të zgjedhësve në pritje për të votuar dhe potencialisht problematikë në mbylljen e qendrës së votimit.

4. Gjatë testimit të funksionalitetit të SEV u vërtetuan mangësi të theksuara në elementët e sigurisë dhe u ngritën dyshime mbi integritetin e sistemit në përgjithësi.

Në vlerësim të të gjitha këtyre fakteve, të evidentuara nga auditët teknicienë dhe specialistët teknikë të subjekteve zgjedhore në lidhje me sigurinë dhe funksionalitetin e SEV, KQZ cmoi se zbatimi i SEV nuk e përmbushte qëllimin e ligjit për të siguruar verifikimin dhe regjistrimin e pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e votimit.

Cënimi i sigurisë së sistemit ishte element substancial në raport me integritetin e procesit zgjedhor në Qarkun e Tiranës. Kjo, dhe të gjitha problemet e evidentuara me sipër, do të ndikonin në cënimin e besimit të të gjitha palëve në procesin zgjedhor.

Mbështetur në nenin 21/2, pika 3, shtojcën III, seksioni 4/pika 4, të Kodit Zgjedhor, KQZ me Vendim Nr.589, datë 18.06.2013, vendosi mos aplikimin e SEV në qarkun e Tiranës dhe zbatimin e procedurave të identifikimit dhe regjistrimit të pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e votimit për zgjedhjet për Kuvendi të datës 23.06.2013 në mënyrë manuale.

Aplikimi i teknologjive SEN dhe SEV në të ardhmen:

Kodi Zgjedhor, në nenin 21/1 "Kompetencë e posaçme e KQZ-së", i ka dhënë KQZ-së kompetencën për të vendosur zbatimin e teknologjisë së informacionit për procesin e identifikimit të zgjedhësve, votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit. Vendimi i KQZ-së në këtë rast duhet të miratohet më votën pro të jo më pak se 5 anëtarëve të saj.

Për zgjedhjet për Kuvendin 2013, legjislatori përcaktoi në Kodin Zgjedhor rregulla të hollësishme procedurale të cilat diktonin çdo hap të procesit të aplikimit në 20% të zgjedhësve, të teknologjisë së informacionit për identifikimin e zgjedhësve dhe numërimin, (neni 179/1 dhe shtojca II dhe III). Këto rregulla të hollësishme u parashikuan në dispozita tranzitore të zbatueshme vetëm për zgjedhjet për Kuvendin 2013.

Pavarësisht se neni 21/1 dhe 21/2 ngarkon KQZ-në për nxjerrjen e rregullave të posaçme për aplikimin e këtyre teknologjive, mendojmë se realisht ka vakum ligjor për sa i përket rregullave procedurale të detajuara për aplikimin e tyre në zgjedhjet e ardhshme, sikundër ishte parashikuar nga Kodi Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin 2013. Gjithashtu vakumi ligjor mendojmë se qëndron dhe në faktin që Kodi Zgjedhor nuk shprehet se si duhet vepruar në rastin kur anulohet zbatimi i teknologjisë pas testimit "a priori", siç ndodhi konkretisht me projektet pilot të vendosur për t'u aplikuar në Zgjedhjet e vitit 2013.

Raporti i OSBE-ODIHR për zbatimin e teknologjive rekomandon" që çdo zbatim i projekteve pilote SEV dhe SEN, të përcaktuara me ligj, të fillojë kohë më parë sesa zgjedhjet e ardhshme ...".

Për të shqyrtuar dhe analizuar të gjithë faktorët në lidhje me aplikimin ose jo të teknologjive të informacionit në lidhje me identifikimin e zgjedhësve, votimin dhe numërimin në zgjedhjet e ardhshme, KQZ duhet të fillonte nga puna sa më parë.



Në kushtet kur KOZ aktualisht ka vetëm 4 anëtar e ka të pamundur marrjen e një vendimi për aplikimin e teknologjive të informacionit.

Vonesat në vendimmarrjen konkrete të KOZ dhe sidomos vakumi ligjor, do të ishin përsëri shkak për të vënë në dyshim zbatimin e këtyre teknologjive në zgjedhjet e ardhshme.

A.3 REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Për zgjedhjet për Kuvend 2013 u regjistruan si subjekte zgjedhore gjithsej 68 parti politike, 66 prej tyre regjistruan lista shumëmemërore. Në KOZ u regjistruan 2 koalicione zgjedhore, në përbërje të të cilave ishin 62 parti politike.


- Koalicioni Aleanca për Punësim Mirëqenie dhe Integrim, i cili kishte pjesëtare 25 parti politike:
 1. Partia Demokratike,
 2. Partia Republikane,
 3. Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet,
 4. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar,
 5. Partia Agrare Ambientaliste,
 6. Partia Lidhja Demokristiane,
 7. Partia Lëvizja e Legalitetit,
 8. Partia Balli Kombëtar,
 9. Partia Bashkimi Liberal Demokrat,
 10. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare,
 11. Partia Balli Kombëtar Demokrat,
 12. Partia Demokristiane e Shqipërisë,
 13. Partia e të Drejtave të Mohuara e Re,
 14. Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen,
 15. Partia Konsevatore,
 16. Partia Ora e Shqipërisë,
 17. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar,
 18. Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian,
 19. Partia Emigracioni Shqiptar,
 20. Partia Lëvizja Shqipëria e Re,
 21. Partia e të Drejtave të Mohuara,
 22. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar,
 23. Partia Demokracia e Re,
 24. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet,
 25. Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare.



- Koalicioni Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim, i cili kishte pjesëtare 37 parti politike:
 1. Partia Socialiste e Shqipërisë,
 2. Partia Aleanca Arbnore Kombëtare,
 3. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane,
 4. Partia Ambientaliste,
 5. Partia Ardhmëria Shqiptare,
 6. Partia Bashkimi Republikan Shqiptar,
 7. Partia Demokratike për Integrim e Prosperitet,
 8. Partia e Çështjeve Shqiptare,
 9. Partia e Gjelbër,
 10. Partia e Punës e Shqipërisë,
 11. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare,
 12. Partia e Unitetit Kombëtar,
 13. Partia G99,
 14. Partia Komuniste e Shqipërisë,
 15. Partia Komuniste e Shqipërisë 8-Nëntori,
 16. Partia Kristian Demokratike e Shqipërisë,
 17. Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim,
 18. Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve,
 19. Partia Mendimi i Djathtë Liberal,
 20. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve,
 21. Partia Personat me Aftësi të Kufizuar,
 22. Partia Rruga e Lirisë,
 23. Partia Shqiptare Atdheu,
 24. Partia Socialpunëtore Shqiptare,
 25. Partia Socialiste e Moderuar,
 26. Partia Socialiste e Vërtetë 91,
 27. Partia Toleranca e Re e Shqipërisë,
 28. Partia Ligji dhe Drejtësi,
 29. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare,
 30. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim,
 31. Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut,
 32. Partia e Punës së Shqipërisë e Riorganizuar,
 33. Partia Demokracia Sociale,
 34. Partia Social Demokratike,
 35. Partia Aleanca Demokristiane,
 36. Partia Pajtimit Kombëtar,
 37. Partia Aleanca Popullore.



Nga totali i 66 parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, 4 prej tyre garuan me vete, ndërsa dy kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit kandiduan përkatësisht në zonat zgjedhore Qarku Vlorë dhe Qarku Fier.



A.4 FLETA E VOTIMIT:

KQZ, me vendimin nr.23, datë 5.02.2013, miratoi modelin dhe specifikimet teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvend 2013. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor sollën garanci të shtuara në lidhje me elementët e sigurisë të fletës së votimit. Për herë të parë, fleta e votimit nuk kishte kundërfletë me numër serial, por si element identifikues u shtua numri respektiv i ZAZ-së dhe QV-së, si dhe elementi i padukshëm në formën e bar-kodeve për çdo fletë votimi. Shtimi i këtyre elementeve të sigurisë në fletën e votimit, veshtirësoi shumë procesin e prodhimit të tyre, duke patur parasysh limitet kohore ndërmjet përfundimit të procedurave të regjistrimit të subjekteve zgjedhore dhe prodhimit të fletës së votimit.

Në ndryshim nga të gjitha zgjedhjet e mëparshme, numri i subjekteve zgjedhore të regjistruara dhe që paraqitën listat shumemërore rezultoi të ishte shumë më i madh, 66 parti politike dhe në dy zona zgjedhore kishte dhe një kandidat të mbështetur nga zgjedhësit. Në këto kushte, KQZ u detyrua të ndryshojë disa specifikime të modelit të fletës së votimit, me qëllim përfshirjen e të gjitha subjekteve zgjedhore garuese në zgjedhjet për Kuvend. Për këtë arsye fleta e votimit në zgjedhjet për Kuvend 2013 ishte me përmasa 600mm x 297mm - në krahasim me - 420mm x 297mm që ishte në zgjedhjet e vitit 2009.

Ndryshimi tjetër në Kodin Zgjedhor, ai i përcaktimit të renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti, u specifikua në vendimin e KQZ-së për miratimin e rregullave të shortit. Pas hedhjes së shortit në seancë publike për 66 parti politike dhe 2 kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit, si dhe duke marrë në konsideratë shmangien e renditjes

së afërt të subjekteve me simbole të ngjashme (që mund të sillte konfuzion te votuesi), u përcaktua përmbajtja e fletës së votimit për të 12 Zonat Zgjedhore.

Pavarësisht problematikave të referuara më lart, procesi i përgatitjes dhe prodhimit të fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvend 2013, u realizua në kohë dhe me standardet e kërkuara, kjo falë vëmendjes dhe masave të ndërmarra nga KQZ.

Për të realizuar prodhimin e fletëve të votimit, sipas përcaktimeve të nenit 97 të Kodit Zgjedhor, KQZ, ndër të tjera duhej të dispononte të gjithë informacionin e saktë për numrin e QV-ve dhe numrin e zgjedhësve për çdo QV. Informacioni i nevojshëm nuk u dërgua në kohë nga një numër i konsiderueshëm i njësive vendore. Për më tepër, kishte raste të ndryshimeve të numrit të QV-ve edhe pas miratimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë. E gjithë kjo problematikë, e vuri KQZ-në në vështirësi ekstreme për prodhimin e fletëve të votimit.

Nisur nga disa reagime të ardhura nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dhe disa KZAZ, KQZ vendosi të bënte krahasimin ndërmjet informacionit të dërguar nga kryetarët e njësive vendore, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe atij që kishin marrë KZAZ-të nga njësitë e qeverisjes vendore. Pas verifikimeve dhe reflektimit të ndryshimeve, KQZ me Vendim Nr.509, datë 5.06.2013, miratoi sasinë e fletëve të votimit që duhet të prodhoheshin për çdo QV, në limite ekstreme kohore – më konkretisht 18 ditë para datës së zgjedhjeve. Sasia e fletëve të votimit të miratuar për prodhim arriti në total 3.337.388 copë për të 5508 QV-të me 3.271.885 zgjedhës.

Me gjithë këto çrregullime të ndodhura në procesin e marrjes së informacionit, masat e marra nga KQZ bënë që të mos kishte problem në përgatitjen dhe shpërndarjen e bazës logjistike të zgjedhjeve.

A.5 INFRASTRUKTURA ZGJEDHORE

A.5.1. Ngritja e Zyrave Rajonale Zgjedhore (ZRZ):

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për miradministrimin e procesit zgjedhor të 23 qershorit, sikundër ka vepruar edhe në proceset zgjedhore pararendëse, si dhe në zbatim të kompetencave të tij, përcaktuar në nenin 21, pika 22, të Kodit Zgjedhor, ngriti 24 Zyra Rajonale Zgjedhore (ZRZ) në të 12 qarqet e vendit. 12 nga këto ZRZ u vendosën në qendrat e qarqeve, ndërsa 12 të tjera në nënprefekturat për të cilat u



mendua se mund të kishte problematikë të mundshme apo që kishin vendndodhje të largët me qendrën e qarkut. Përzgjedhja e 24 inspektorëve rajonalë u bë mbi bazë të njohurive të tyre për procesin zgjedhor, eksperiencës së tyre sa i përket mënyrës së menaxhimit të problematikave, njohjes së terrenit, etj., konkretisht: 14 prej të angazhuarve kishin eksperiencë si inspektor rajonalë në dy procese zgjedhore, 3 kishin eksperiencë në katër procese zgjedhore dhe për 7 prej tyre ishte eksperiencë e parë. Inspektorët rajonalë u trajnuan për procesin e pritshëm zgjedhor, i cili do të shënonte sfida të reja falë ndryshimeve të rëndësishme të Kodit Zgjedhor.


Zyrat Rajonale Zgjedhore dhanë një ndihmesë të madhe në organizimin e punës dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme, duke kontaktuar vazhdimisht me organet e pushtetit lokal, drejtoritë e ndryshme Rajonale, Institucionin e Prefektit dhe Nënprefektit si dhe institucionet e tjera shtetërore për të cilat Kodi Zgjedhor përcakton detyra konkrete për mbarëvajtjen dhe sigurinë e procesit zgjedhor. E një rëndësie të veçantë ishte angazhimi i Zyrave Rajonale për monitorimin dhe koordinimin e punës së KZAZ-ve më organet e pushtetit vendor, dhënien e konsulencës ligjore dhe zgjedhore për KZAZ-të, inspektimin e ambienteve private të propozuara për qendra votimit, inspektimin e përgatitjeve për përshtatjen e ambienteve dhe krijimin e kushteve për vendet e numërimit të votave, si dhe inspektime të ndryshme sipas problematikës së hasur gjatë procesit zgjedhor apo të kërkuar nga KQZ.

Me gjithë përpjekjet e KQZ-së për të optimalizuar kushtet e punës së këtyre strukturave, u hasën problematika në infrastrukturën teknike dhe logjistike, e cila vështirësoi efikasitetin e komunikimit. Pas përmbylljes së procesit, u organizua në KQZ një mbledhje pune me të gjithë inspektorët rajonalë, me synim evidentimin e problematikave për përmirësim në të ardhmen. Nga diskutimi dhe shkëmbimi i mendimeve, del domosdoshmëri që në të ardhmen organet e pushtetit vendor, apo qendror të jenë më bashkëpunues dhe efektivë për sigurimin e infrastrukturës logjistike (pajisje zyre) dhe mundësisë së vënies në dispozicion të një infrastrukture komunikimi që i shërben procesit. Gjithashtu del domosdoshmëri, shtimi i buxhetit për këtë strukturë të administratës zgjedhore, pasi vetë operacionaliteti i punës së tyre e dikton këtë kërkesë. Ndjekja në dinamikë e problematikave të cilat i asistojnë/raportojnë në KQZ dhe kontribuojnë për zgjidhje, i angazhon këto struktura vazhdimisht në terren, në lëvizje nga njëra qendër votimi në tjetrën.



A.5.2. Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve:

Në nivel të dytë, procesi zgjedhor i 23 qershorit, u administrua nga 89 Komisione Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ). Shtimi në këto zgjedhje i numrit të KZAZ-ve, 23 KZAZ më shumë se në proceset zgjedhore të 2009-ës dhe 2011, sipas numrit të shtuar të Zonave



të Administrimit Zgjedhor, pati një ndikim shumë pozitiv në administrimin e procesit nga administrata zgjedhore. KZAZ-të administruan më lehtësisht e profesionalisht procesin, pasi kishin në juridiksionin e tyre territore më të vogla dhe administruan procesin për një numër më të vogël zgjedhësish.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përmbushje të njërës prej detyrave të tij funksionale, asaj të përcaktimit të përbërjes së KZAZ-ve që do të ngriheshin për procesin zgjedhor të 23 qershorit 2013, me vendimin Nr.1, datë 07.01.2013, caktoi partitë politike që iu lindte e drejta e propozimeve të anëtarëve të KZAZ-ve. Ky akt, i nxjerrë në zbatim të urdhërimeve të nenit 29 të Kodit Zgjedhor, përcaktoi numrin e anëtarëve që do të propozonin partitë kryesore dhe të dyta të shumicës dhe opozitës parlamentare, në funksion të garantimit të baraspeshimit politik të përbërjes së KZAZ-ve. Mbi bazën e faktit publik të daljes së LSI nga partitë që i përkasin shumicës parlamentare, Partia Republikane, si parti e dytë e shumicës parlamentare kërkoi nga KQZ dhënien e së drejtës për propozimin e anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore (kërkesa nr. 3335 prot., datë 04.04.2013).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në ushtrim të përgjegjësive, funksioneve dhe kompetencave të tij ligjore, në zbatim rigoroz të urdhërimeve dhe përcaktimeve ligjore të Kodit Zgjedhor dhe Kodit të Procedurave Administrative, me vendimin nr. 265, datë 23.04.2013, ndryshoi pjesërisht Vendimin nr.1, datë 7.01.2013.

Partia Republikane, në rrethanat e faktit, parti e dytë e shumicës parlamentare, do të propozonte nga një anëtar në çdo KZAZ.

Të gjitha KZAZ-të, janë ngritur brenda afateve ligjore dhe kanë zhvilluar rregullisht mbledhje në funksion të punës. Mbledhja e parë e KZAZ-ve u zhvillua në datat 29-30 Mars, sipas përcaktimit të vendimit të KQZ nr. 178, datë 25.03.2013, duke shënuar njëherazi dhe fillimin e procedurave për ngritjen e infrastrukturës zgjedhore sipas zonave përkatëse.

Përgjithësisht KZAZ-të funksionuan normalisht duke përmbushur detyrat e tyre me profesionalizëm. Në këtë aspekt, ndihmoi mirëorganizimi dhe realizimi i trajnimit të këtyre komisionerëve nga ana e KQZ-së, i cili dha impakt të drejtpërdrejtë në mirë administrimin e procesit nga këto komisione, brenda sferës së kompetencave të tyre. Testimi i njohurive në përfundim të procesit të trajnimit dëshmoi për nivel shumë të mirë të kuptimit të ligjit zgjedhor në përgjithësi dhe detyrave, përgjegjësi, e procedurave konkrete të KZAZ-ve në veçanti. Rastet sporadike të evidentuara në punën e disa KZAZ-ve, të cilat paraqitën probleme lidhur me zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor apo vendimeve të KQZ-së, nuk kishin të bënin me moskuptim apo paqartësi për kuadrin ligjor zgjedhor, por për shkak se disa komisionerë, në ushtrim të detyrës së tyre dëshmuuan qëndrime dhe vullnete individuale të cilat prevaluuan mbi detyrën, raste për të cilat KQZ përdori të gjithë autoritetin e vet ligjor.

Administrimi i procesit të 23 qershorit, në nivelin e dytë të tij u cënua sërish nga partitë politike, sikundër ka ndodhur edhe në procese pararendëse, të cilat shfrytëzuan të drejtën e tyre ligjore për lirime/emërime të anëtarëve apo sekretarëve të KZAZ-ve, edhe pasi ata kishin marrë trajnimin e nevojshëm nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. KQZ disponoi me 35 vendime zëvendësimit e kërkuara nga partitë politike (lirim-emërim). Nga totali i përgjithshëm prej 712 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve u zëvendësuan 253 prej tyre, nga këta 4 anëtarë gjatë ditës së zgjedhjeve, në përqindje 35.5%. Në analizë të krahasuar me vitin 2009, ku në detyrën e anëtarit/sekretarit të KZAZ kanë shërbyer 528 komisionerë, dhe nga ky numër janë liruar/zëvendësuar 146 komisionerë, pra 28% e numrit të përgjithshëm, dëshmohet qartë trendi në rritje i diskrecionit të partive politike për të liruar/zëvendësuar burimet njerëzore të këtyre strukturave.

Gjithashtu, kuota gjinore e respektuar në momentin e paraqitjes së propozimeve, nuk mbahet gjithmonë në vëmendje nga partitë politike në zëvendësimet në vijim.

KZAZ-të, përgjithësisht përmbyllën korrektësisht detyrat e tyre që burojnë nga kuadri ligjor zgjedhor, duke garantuar shpërndarjen në kohë të bazës materiale zgjedhore



për të gjitha QV-të në juridiksionin e tyre, morën në dorëzim materialet e votimit, miratuan tabelat përmbledhëse të rezultatit, si dhe dorëzuan në KOZ materialet zgjedhore pas përfundimit të procesit. Megjithatë, gjerësisht u evidentua nga inspektimet e kryera mosrespektimi i orareve të punës nga KZAZ-të, sipas përcaktimit në udhëzimin e KOZ-së. Me afrimin e datës së zgjedhjeve dhe me intensifikimin e punës së KZAZ-ve, kjo problematikë u zbeh dhe thuajse në të gjitha rastet në zyrat e KZAZ-ve kishte prezencë të komisionerëve të përkatësive të pozitës dhe opozitës parlamentare. Fakti se anëtarët e KZAZ-ve, përgjithësisht janë nëpunës të administratës publike, dhe ndërkohë emërimi si komisionerë të KZAZ-ve përbën një angazhim të dyfishtë, paraqet një problematikë që reflekton në cedimin ndaj detyrës së tyre. Nisur nga ky konstatim, duhet të konsiderohet nevoja e një rregullimi ligjor që të shmangë pengesat në ushtrimin e detyrës së anëtarit të KZAZ-së.

Në përmbyllje të procesit, u evidentua nga KOZ një problematikë për sa i përket zbatimit korrektësisht të ligjit nga KZAZ-të në momentin procedural të administrimit të propozimeve dhe emërimit të anëtarëve të KOV-ve. KZAZ-të duhet të disponojnë me vendimmarrje emërimin e anëtarëve të KOV-ve, bazuar në propozimet e partive politike që gëzojnë këtë të drejtë sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor si dhe në përmbyllje të procedurave të verifikimit për ekzistencën apo jo të shkaqeve të papajtueshmërisë me detyrën. Ndryshimet e Kodit Zgjedhor, konsistuan dhe në ndryshime të rregullimeve sa i përket procedurave të emërimit të anëtarëve të KOV-së: risi ishte se emërimit të anëtarëve të KOV, subjektet propozues, nuk mund të kërkonin lirimin e tyre nga detyra.

Dokumentacioni i KZAZ-ve dorëzuar në KOZ, dëshmonte për mosrespektim të këtij kushti ligjor, pasi për një numër jo të vogël të KZAZ-ve, rezultonte se:

- Disponohen dy sete vendimesh të KZAZ-së për të njëjtën përbërje të KOV-së; të dy vendimet kanë numër dhe datë të njëjtë, por pasqyrojnë anëtarësi të ndryshme, fakt i cili "zbulon" kompromisin joligjor të KZAZ-ve me partitë politike. Nga këto KZAZ janë disponuar me vendime emërimi, propozime fiktive, thjesht për të respektuar afatin kohor ligjor, dhe më pas janë kryer emërimet reale me një vendim të dytë, një apo dy ditë përpara zgjedhjeve.
- KZAZ-të pasqyronin në mënyrë fiktive në Librin e Protokollit, propozimet e dorëzuara nga partitë politike për emërimin e anëtarëve të KOV-së, dhe më tej vendimet e marra për emërimin e tyre, ndërsa realisht nga partitë politike nuk ishin paraqitur ende lista, apo ishin paraqitur lista jo të plota.



- Emërimet shumë të vonuara të anëtarëve të KQV-ve, për shkak të mosrespektimit të afatit kohor për paraqitjen e propozimeve nga partitë politike, por edhe të frymës së kompromisit të dëshmuar nga KZAZ, ndikuan negativisht në procesin e trajnimit të anëtarëve të qendrave të votimit.


Vendimet e KZAZ-ve në pjesën më të madhe të rasteve janë marrë me konsensus, dhe nuk është shënuar në as dhe një rast bllokim i punës apo të vendimmarrjes dhe dërgimi i çështjes në KOZ, kjo dhe si rezultat i ndjekjes në dinamikë të punës së këtyre komisioneve nga strukturat e KOZ-së. KZAZ-të përgjithësisht, me dy-tre raste përjashtimore, nuk arritën të nxjerrin tabelat përmbledhëse të rezultateve për zonat respektive të administrimit zgjedhor në afatin e kërkuar nga Kodi Zgjedhor – jo më vonë se ora 22.00 e ditës së nesërme të votimit.

Rasti i KZAZ-së nr. 13, qarku Lezhë, i konstatimit të mospërputhjes së shifrave të rezultatit të tabeluar nga kjo KZAZ me ato të transmetuara paraprakisht, evidentuar gjatë procedimit për nxjerrjen e rezultatit nga KOZ-ja për këtë qark, iu nënshtrua një hetimi të thelluar administrativ. Pas përmbylljes së procedimit administrativ, mbi bazën e të dhënave të vërtetuara për veprimtarinë joligjore, për komisionerët përgjegjës KOZ depozitoi kallzim penal pranë organit të Prokurorisë.

A.5.3. Ngritja dhe funksionimi i KQV-ve

Në nivel të tretë, procesi zgjedhor i 23 qershorit 2013, u administrua nga 5508 komisione të qendrave të votimit (KQV). Në rang vendi u caktuan 5508 qendra votimi, nga këto 551 QV, ose 10%. e totalit, kanë qenë të vendosura në ambiente private.

551 QV në ambiente private



Partitë politike nuk zbatuan detyrimin ligjor për dorëzimin e propozimeve për anëtar të KQV-ve pranë

KZAZ-ve jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve. KZAZ-të, në çdo rast duhet të përmbyllin procedurat e emërimeve përkatëse jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve. Pavarësisht mirë përcaktimeve të afateve kohore në ligj, ecuria e procesit dëshmoi në shumicën e rasteve mos respektimin e urdhërimeve ligjore nga ana e partive politike, sjellje e cila passolli emërime të vonuara të komisionerëve të nivelit të tretë, duke cënuar eficientësinë e procesit të trajnimit të tyre.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke e ndjekur në dinamikë dhe me shqetësim këtë proces, bëri thirrje të vazhdueshme për partitë politike, duke shfrytëzuar për këtë qëllim të gjitha rrugët e mundshme të komunikimit. Gjithashtu, të gjitha KZAZ-të, i kanë adresuar degëve të partive politike në rrethet përkatëse kërkesën për paraqitjen e propozimeve. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, partitë politike përgjithësisht paraqitën propozime për emërimin e anëtarëve të KQV-ve, vetëm në çastet e fundit, përpara se të shpërndahej baza materiale.

Kjo sjellje në mosrespektim të ligjit nga partitë politike, fatkeqësisht e përsëritur në të njëjtën mënyrë e masë, si edhe në proceset zgjedhore pararendëse, dëmtoi punën dhe funksionimin e komisioneve zgjedhore të nivelit të tretë, duke vështirësuar mirë administrimin e procesit zgjedhor. Vonesat në propozime, apo emërimet në limitet e fundit para ditës së zgjedhjeve, përveç cenimit të procesit të trajnimit, duke reflektuar negativisht në njohuritë e komisionerëve për procedurat gjatë ditës së votimit, sjell edhe fenomenin tjetër negativ: të pamjaftueshmërisë së kohës fizike për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve sa i përket respektimit të kriterëve të kërkuara ligjore për emërimin e këtyre anëtarëve.

KQV-të në të gjithë vendin përgjithësisht respektuan kriteret ligjore për orarin e hapjes dhe mbylljes së qendrave të votimit, duke kryer korrektësisht procedurat përkatëse. Mbyllja e votimit dhe dorëzimi i kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore në KZAZ, në të gjithë vendin u krye me korrektësi dhe në afate kohore: rreth orës 22.00 të datës 23 qershor të gjithë QV e vendit kishin kryer dorëzimet e kutive dhe materialeve zgjedhore në Vendet e Numërimit të Votave (VNV) respektive. Vetëm një qendër votimi në Komunën Livadhja nuk u hap për shkak të kundërshtive nga kryetari i kësaj komune.

KQV-të i kryen me korrektësi procedurat dhe detyrat e tyre gjatë ditës së votimit. Në ndryshim të ndjeshëm nga gjithë zgjedhjet e tjera, vetëm 2 kuti votimi në të gjithë territorin e Shqipërisë u konsideruan si të parregullta nga ana e grupeve të marrjes në dorëzim. Po kështu, një numër tejet i vogël i kutive të materialeve zgjedhore iu nënshtruan procesit të verifikimit, për shkak të mos gjetjes së PV- KQV-08 tek kutia e votimit, fakte të cilat dëshmojnë për zbatimin me korrektesë të procedurave nga komisionerët e nivelit të tretë.



A.5.4. Ngritja dhe funksionimi i GNV-ve:

Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, pasi KQZ ka përcaktuar partitë politike të cilave ju lind e drejta për të propozuar anëtarë të grupeve të numërimit, këto të fundit duhet të paraqesin propozimet përkatëse në KZAZ-në respektive 12 ditë para datës së zgjedhjeve.

Në rang kombëtar funksionuan 940 grupe numërimi, propozimet në të gjitha rastet u paraqitën nga partitë politike në tejkallim të afateve ligjore, pothuaj në limitet e fundit, sjellje e cila jo vetëm cënon zbatueshmërinë e ligjit, por defekton dhe procesin zgjedhor në një nga momentet me të rëndësishme të tij: atë të numërimit të votave!

Emërimi i numëruesve në momentet e fundit, për shkak të propozimeve të vonuara, cënoi rëndë procesin e trajnimit të këtyre strukturave, duke e reduktuar nga planifikimi një ditë, me kohë të mjaftueshme për qartësim të çdo procedure, në trajnim me kohë të pamjaftueshme dhe të kryer në VNV (ndërkohë që merret në dorëzim baza materiale), duke shkaktuar dhe vonesa në fillimin e procedurave të numërimit.

Rritja e numrit të KZAZ-ve si dhe ndryshimet ligjore sa i përket procedurave që ndiqen gjatë procesit të numërimit, konkretisht të mos hapjes së kutisë së materialeve zgjedhore, vetëm në rast të mos ndodhjes së procesverbalit të mbylljes së votimit në kutinë e votimit, ndihmuan në përshpejtimin e procesit të numërimit, dhe zbehjen e situatave bllokuese gjatë procesit nga KZAZ-të apo GNV-të.

Mbarëvajtjes së procesit të numërimit, dhe uljes së numrit të votave të pavlefshme në rang vendi, pra leximit më të mirë të vullnetit të shprehur të zgjedhësve, i shërbeu Vendimi i KQZ-së Nr. 172, datë 27.02.2013 "Për unifikimin e praktikës së vlerësimit të fletëve të votimit nga personat e ngarkuar nga Kodi Zgjedhor, për numërimin dhe vlerësimin e votave". Efekti pozitiv i këtij vendimi dëshmohet nga shifrat konkrete: nga 46.615 vota të pavlefshme në zgjedhjet e kaluara, në këto zgjedhje u cilësuan si të tilla vetëm 24.181 vota, pra një reduktim pothuaj 50 %.

Ky vendim unifikues për vlerësimin e votës, i marrë nga KQZ si rezultat i vlerësimit të praktikave të shkuara, parandaloi debatet, vonesat dhe bllokimet gjatë procesit të numërimit, të cilat vinin si pasojë edhe e mos mbajtjes së një standarti vlerësues nga KZAZ-të.



Në përgjithësi procesi i numërimit të votave shkoi shumë mirë. Siguria në Vendet e Numërimit të Votave ka qenë në të gjitha rastet në lartësinë e kërkuar dhe puna e bërë nga Policia e Shtetit ka qenë e lavdërueshme.

A.5.5 Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë

Në zbatim të përcaktimeve të nenit 108 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 1, datë 12.12.2012 "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet", KQZ i ka kërkuar të gjithë kryetarëve të bashkive dhe komunave dërgimin e listës së qendrave të votimit ku janë regjistruar zgjedhës të cilët janë persona me aftësi të kufizuar (të verbër dhe zgjedhësit tetraplegjikë dhe paraplegjikë) dhe që kanë nevojë për infrastrukturë ndihmëse për të votuar lirisht në qendrën e votimit. Në përgjigje të kësaj kërkesë të përsëritur, këtij detyrimi ligjor iu përgjigjën **285 bashki dhe komuna**, dhe nga agregimi i të gjithë të dhënave në rang vendi, rezultoi se ishin regjistruar **8466 zgjedhës të verbër** dhe **4335 zgjedhës para/tetraplegjikë**. Zgjedhësit para/tetraplegjikë ishin të regjistruar në **2045 QV** në të gjithë vendin.

Duke parë se dinamika e përgjigjeve të kryetarëve të bashkive/komunave ishte shumë e ngadaltë dhe jo tërësore, si dhe nisur nga interesi për të patur një listë dhe panoramë të saktë të shpërndarjes së kësaj kategorie zgjedhësish në nivel njësie vendore dhe qendre votimi, u kërkuua paralelisht edhe një informacion nga Shërbimi Social Shtetëror, i cili është edhe institucioni që mbulon përkrahjen sociale të shtresave në nevojë, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuar. Duke qenë se spektri i këtij grupi social që SHSSH mbulon është shumë i gjerë, e për rrjedhojë dhe kategorizimi i ndihmës sociale është i ndryshëm, të dhënat e marra nga ky institucion nuk na ndihmuan aq sa pritej për të krahasuar apo përmirësuar informacionin zyrtar që KQZ merr nga bashkitë dhe komunat, por pavarësisht nga ky fakt, u krijua një pamje krahasuese mbi numrin e këtyre personave që marrin ndihmë sociale dhe atyre që janë të regjistruar si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë.

Përveç impenjimit të KQZ-së, çështja e aksesit të zgjedhësve që nuk mund të votojnë vetë ka patur edhe interesin e shoqatave, por edhe të subjektit politik që përfaqëson



këtë kategori zgjedhësish, si dhe vëmendjen e Komisioneres për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit, Ambasadorit të SHBA-së, etj. KOZ ka patur një bashkëpunim shumë të mirë me Këshillin Kombëtar të Shoqatave të Personave me Aftësi të Kufizuar për çfarë konkretisht ka qenë e nevojshme ndërhyrja e KOZ-së për të mundësuar hyrjen në qendrën e votimit, (të verbrit, invalidët e punës, personat para/tetraplegjikë dhe personat që nuk dëgjojnë).

Duke parë rëndësinë reciproke të këtij bashkëpunimi KOZ, nënshkroi edhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Këshillin Kombëtar të shoqatave të personave me aftësi të kufizuar. Mbështetur në kushtet dhe burimet reale që KOZ arriti të shfrytëzojë për t'i dhënë mundësinë zgjedhësve që nuk mund të votojnë vet, në zgjedhjet për Kuvend të datës 23 qershor 2013, u përdoren dhe koordinuan për këtë kategori zgjedhësish komponentët e mëposhtëm:

- U miratuan në strukturën buxhetore të gjitha elementët e parashikuara në Kodin Zgjedhor për zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë (rampa, maske për fletën e votimit, dhoma të fshehtësisë). Për më tepër u katërfishua fondi për ndërtimin e rampave, kjo në krahasim me parashikimin këtij fondi për zgjedhjet e vitit 2011.
- Për përdorimin sa më efikas të këtij fondi tentuam që të gjenim një zgjidhje të përhershme, praktike dhe në funksion të vazhdueshëm të kësaj kategorie zgjedhësish – duke ndërtuar **rampa betoni** në shkallët e objekteve të QV-ve. Duke qenë të vetëdijshëm, që kjo zgjidhje nuk mund të ofrohej për të gjitha QV-të e evidentuara, i kërkua Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar që të identifikojnë QV-të më prioritare, të cilat ndodhen në objekte publike dhe ku votojnë më shumë zgjedhës të kësaj kategorie. Në përgjigje të kësaj kërkesë dhe me një bashkëpunim shumë të mirë me këtë Fondacion, u pilotua me sukses ky projekt në 3 Bashki: Tiranë, Elbasan dhe Shkodër. Duhet nënvizuar se qëllimi i këtij projekti, nuk ishte vetëm ofrimi i një zgjidhje të përhershme, duke ndërtuar infrastrukturë ndihmëse të palëvizshme, por edhe sensibilizimi i autoriteteve lokale, të cilat kanë detyrimin ligjor që ta ngrenë këtë infrastrukturë në të gjitha objektet publike që kanë në administrim – ku pjesa më e madhe shërbejnë edhe si qendra votimi.
- Orientimi i pushtetit vendor dhe KZAZ-ve për caktimin e QV-ve në katet e para të ndërtesave në ato raste ku votojnë personat me aftësi të kufizuar;



- Trajnimi i komisionerëve të KQV-ve për ndihmën që duhet t'i japnin personave me aftësi të kufizuar në ushtrimin e të drejtës së votës;
- Përfshirja e gjuhës së shenjave në fushatën televizive për sensibilizimin e zgjedhësve dhe edukimit qytetar;

Eksperienca e zgjedhjeve për Kuvend 2013 tregoi se ushtrimi i të drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuar është një çështje e cila mbart një problematikë të vazhdueshme, e cila përfshin përgjegjësinë jo vetëm të KQZ-së, por edhe të shumë institucioneve të tjera qendrore dhe vendore, pa bashkëpunimin dhe vullnetin e të cilave, detyrimi për të garantuar të drejtën e votës duke ngritur mekanizma dhe infrastrukturë ndihmëse të përhershme, do vazhdojë të jetë një sfidë edhe për proceset e ardhshme zgjedhore.

Me këtë këndvështrim, KQZ, pas përfundimit të procesit zgjedhor organizoi një Tryezë Teknike me Autoritete, Institucione dhe Grupe të Interesit që janë të angazhuar dhe veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave për personave me aftësi të kufizuar.

Tryeza kishte për qëllim të ngrinte një debat sa më të hapur, profesional dhe teknik, duke u fokusuar në fakte dhe analiza konkrete të përgjegjësive institucionale, por edhe të angazhimit të ndërsjellët për të kontribuar në garantimin e kushteve dhe lehtësimin e personave me aftësi të kufizuar në ushtrimin e të drejtës së votës. Kjo nismë ka dalë me konkluzione dhe rekomandime konkrete, të cilat do të jenë pjesë e një pakete të plotë Rekomandimesh për Komisionin Parlamentar për Reformën e pritshme Zgjedhore.

A.6 TRAJNIMI I ANËTARËVE TË KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve

A.6.1 Përgatitja e programit të trajnimit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke synuar rritjen e profesionalizmit të administratës zgjedhore të nivelit të dytë e të tretë, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, mori masat e nevojshme për organizimin dhe realizimin e programit të trajnimit për këto struktura. Konsideruar faktin se administrata zgjedhore e nivelit të dytë e të tretë që do të ngrihej dhe funksiononte për këtë proces zgjedhor, ishte numerikisht më e madhe, falë



ndryshimeve të Kodin Zgjedhor, u maksimalizua vëmendja për mirëorganizimin në shkallë vendi të trajnimeve të komisionerëve. KQZ fillimisht me Vendim Nr. 19, datë 28.01.2013, miratoi strategjinë e Trajnimit, qëllimi kryesor i së cilës ishte: “Realizimi i misionit të KQZ-së nëpërmjet kualifikimit dhe ngritjes së nivelit profesional të anëtarëve të komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta për mbarëvajtjen e procesit në zonën e administrimit zgjedhor, në qendrën e votimit dhe në vendin e numërimit të votave, në funksion të realizimit të zgjedhjeve të lira, të ndershme, të barabarta, transparente dhe demokratike në përputhje me parimet dhe rregullat e vendosura në Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”.

Në zbatim të hapave konkretë që strategjia përcaktonte, u përgatitën dhe realizuan teknika dhe materiale trajnuese, si manuale, prezantime powerpoint, dhe mjete të tjera, të cilat shërbyen për zhvillimin e trajnimeve gjatë këtij procesi zgjedhor. Njohuritë kryesore që i shërbyen komisionerëve në përmbushjen e detyrës së tyre nëpërmjet manualeve për KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të, u përgatitën sipas strategjisë së trajnimit si në përmbajtje dhe në formë, me shembuj teknike dhe specifike.

Manualet e trajnimit, pavarësisht se botohen për çdo proces zgjedhor, në këto zgjedhje reflektuan ndryshimet e Kodit Zgjedhor, kuadrin nënligjor të miratuar nga KQZ për këtë proces, si dhe amendimet e Kodit Penal për vepra penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Përveç përmbajtjes, manualët u konceptuan edhe në formë për të qenë më praktik, të kuptueshëm dhe lehtësisht të përdorshëm.


Risi në këtë proces ishte hartimi në bashkëpunim me IFES, i manualit “Guida e trajnerëve”, i cili jo vetëm do të qartësonte hapat që ndodhin në KQV, por edhe si një mjet ndihmës për trajnerët e KQV-ve.

Për të realizuar cilësisht qëllimin e strategjisë së trajnimit, u krye përzgjedhja e trajnuesve, mbi bazën e një procesi transparent dhe të bazuar në plotësimin e kriterëve specifike të kërkuara, duke rekrutuar kryesisht trajnues me eksperiencë zgjedhore, duke i dhënë përparësi arsimit juridik, dhe që demonstruan aftësi në transmetimin e njohurive lidhur me zgjedhjet.




Struktura e trajnuesve për trajnimin e anëtarëve të:


- KZAZ-ve- 52 trajnues (mbi 80 % me eksperiencë zgjedhore dhe 50% me arsimim juridik e 37% mësuesi);



- KQV-ve - 280 trajnues (mbi 65 % me eksperiencë zgjedhore dhe mbi 24% me arsimim juridik e 35% mësuesi);



- GNV-ve - 90 trajnues (80 % me eksperiencë zgjedhore dhe mbi 36% me arsimim juridik e 32% mësuesi);



A.6.2 Zhvillimi i programit të trajnimit

Sikundër parashikonte Strategjia e Trajnimit, fillimisht u zhvillua programi i përqëndruar i trajnimit të trajnuesve të KZAZ-ve (52 trajnues), të cilët u trajnuan në dy grupe, së bashku me inspektorët rajonalë. Edhe trajnimi i trajnuesve të KQV-ve dhe GNV-ve u krye në mënyrë të përqëndruar. Ky program u shtri në një periudhë kohore intensive - 7 ditore, sipas skemës së miratuar të trajnimit.

Rritjes së cilësisë së trajnimit i shërbeu trajtimi nga një ekspert i komunikimit, me mbështetjen e KiE, i modulit “Mbi mënyrën e prezantimit të trajnuesve” dhe “Për etikën dhe teknikat e komunikimit efektiv”.



Për herë të parë në historikun e institucionit, një person me aftësi të kufizuar u angazhua si personel i përkohshëm pranë Sektorit të Trajnimeve, duke dhënë kontribute të çmuara si eksperte për këtë kategori zgjedhësish, në hartimin e manualeve të trajnimit, dhe si trajnere, duke dhënë informacionet për procedurat e votimit që ndjek kjo kategori zgjedhësish.

Trajnimi i anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, synoi dhe realizoi përcjelljen teorike dhe praktike të procedurave në zonën e administrimit zgjedhor, të drejtat dhe detyrat e komisionerëve zgjedhorë, kërkesat e Kodit të Sjelljes miratuar nga KQZ-ja, procedurat gjatë ditës së zgjedhjeve, procesit të numërimit të votave, rastet e ndërhyrjes së tyre në proces, transmetimin e të dhënave në rrugë elektronike, plotësimi i tabelës së rezultateve përfundimtare, përdorimin e modeleve të dokumentacionit të punës, etj. Vëmendje dhe fokus i veçantë iu kushtua dispozitave të shtuara të Kodit Penal, për veprat penale në zgjedhje.

Trajnimi i anëtarëve të KQV-ve është zhvilluar kryesisht më datë 13-18 qershor, por edhe jashtë kësaj periudhe, në varësi të kërkesave të KZAZ-ve dhe partive politike. Programi i trajnimit përfshinte trajtimin teorik dhe praktik të çdo procedure që kuadri ligjor përcakton për ditën e votimit, nga marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore deri në mbylljen e votimit dhe dorëzimin e materialeve në KZAZ, duke u fokusuar në shmangien e fenomeneve negative si votimi familjar, fotografimi i votës, rendi në QV etj.

KQZ, duke konsideruar si primare trajnimin e çdo komisioneri, u tregua fleksibël lidhur me orarin, kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe zhvillimin e trajnimit edhe në ambiente jo të caktuara nga KQZ-ja. Megjithë angazhimin sa i përket organizimit dhe zhvillimit të trajnimeve, problem shqetësues mbetet pjesëmarrja jo e plotë e komisionerëve në seancat e trajnimit të organizuara nga KQZ-ja, si dhe zëvendësimi i një numri të madh komisionerësh të trajnuar.

Për shkak të emërimit me vonesë të anëtarëve të GNV-ve, trajnimi i tyre nuk u realizua sipas parashikimit: për një numër të vogël numëruesish u krye një ditë para datës së zgjedhjeve, ndërsa për pjesën më të madhe u krye vetëm pas marrjes në dorëzim nga KZAZ-ja të materialeve zgjedhore të sjella nga KQV-ja.



Për sa i përket metodologjisë së përdorur në procesin e trajnimit, u dëshmuua nga mendimet/opinionet e komisionerëve se ishte e përshtatshmeja dhe e duhura. Manualët dhe materialet e përdorura realizonin më së miri qëllimin e trajnimit, ishin të qarta, të kuptueshme, të detajuara, shumë afër praktikës, me shembuj konkretë, konçizë dhe praktikë. Komisionerët, në takimet e organizuara pas përfundimit të procesit, u shprehën se manualët shërbyen si udhëzues shumë të mirë gjatë procesit. Gjithsesi, nuk mund të lihen pa evidentuar problemet që u shfaqën gjatë procesit:

- Partitë politike, nuk i paraqitën propozimet për anëtarë të KQV dhe GN në afatin e duhur ligjor;
- Lirimet/emërimet e komisionerëve të KZAZ-ve, por edhe të KQV-ve pas trajnimit të tyre nga KQZ;
- Mosparaqitja e komisionerëve për t'u trajnuar në kohën dhe vendin e trajnimit;
- Trajnimi i komisionerëve nga vetë partitë politike;
- Anëtarët e KQV-ve dhe GNV-ve, gjatë zhvillimit të sesioneve të trajnimit, nuk pranorin të identifikoheshin duke mos nënshkruar në listën e pjesëmarrjes në trajnim, praktikë e ndjekur në vite, për shkak të mentalitetit që një i emëruar i bërë publik rrezikon të mos i qëndrojë besnik partisë politike që e ka propozuar.

Fatkeqësisht, këto probleme që çenojnë cilësinë dhe efikasitetin e trajnimit, evidente edhe në raportet përfundimtare të OSCE/ODIHR për zgjedhjet e mëparshme (2005, 2007, 2009, 2011), dëshmojnë probleme të cilat gjenerohen nga veprime/qëndrime të partive politike, dhe nuk mund të gjejnë zgjidhje vetëm me angazhimin e KQZ-së. Duhet theksuar se sukesi i programit të trajnimit ishte edhe si kontribut i asistencës teknike që i është ofruar KQZ-së nga partnerët ndërkombëtarë, si Prezenca e OSBE-së në Shqipëri për ekspertizën në ndërtimin e strategjisë së trajnimit; Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë për hartimin e manualeve të trajnimit për KZAZ, KQV, GNV dhe trajnimin për etikën dhe komunikimin, Projekti i Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet e Zgjedhjeve (IFES), OSBE dhe KiE për organizimin e trajnimit të trajnuesve.

I gjithë programi i trajnimit u monitorua dhe vlerësua nga vëzhguesit e huaj (OSBE/ODIHR) vëzhgues vendas, si dhe janë pasqyruar edhe në media të ndryshme.



A.7 EDUKIMI ZGJEDHOR I SHTETASVE

Edukimi zgjedhor i shtetasve, u realizua nëpërmjet një strategjie të detajuar të miratuar me vendimin nr.173, datë 05.02.2013, qëllimi specifik i së cilës ishte gjetja e formave bashkëkohore të komunikimit me shtetasit që gëzojnë të drejtën e votës, koordinimi e më pas vënia në jetë e projekteve të ndryshme, duke synuar si objektiva për realizim:

- Rritjen e pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje, duke informuar për datën e mbajtjes së tyre, dhe duke synuar ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e ushtrimit të së drejtës të votës;
- Paraqitjen e një informacioni sa më të gjerë mbi procedurat që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor në tërësi;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të zgjedhësve mbi rolin e KOZ-së si një organ të pavarur dhe profesional, ku mund të kihej besim i plotë për administrimin e paanshëm dhe të drejtë të procesit zgjedhor.

Projektet e edukimit të zgjedhësve, që u shtrinë në të gjithë territorin e vendit, fokusuan përcjelljen e materialit edukativ zgjedhor në forma të ndryshme, në mënyrë që i gjithë procesi të ishte sa më pranë dhe sa më qartë në vëmendjen e zgjedhësve, duke përdorur të gjitha mjetet dhe rrugët për të përcjellë të gjithë informacionin e nevojshëm. Vëmendje iu kushtua përcjelljes së informacionit nëpërmjet mediave lokale në zona ku ishte evidentuar pjesëmarrje e ulët në votime ose mangësi informimi për grupime të ndryshme shoqërore.


Strategjia për edukimin e zgjedhësve në fokus të fushatës edukuese të ndërmarrë nga KOZ, kishte target-grupet e veçanta të minoriteteve; votuesit e rinj; personat me aftësi të kufizuar; gratë dhe specifikisht ato shtëpiake. Për këto grupe u realizuan projekte të posaçme, duke transmetuar mesazhe më specifike.

Programi për edukimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve u realizua kryesisht nëpërmjet medias së shkruar edhe asaj elektronike. Media, duke krijuar mundësinë e një komunikimi shumë aktiv me të gjithë zgjedhësit, si dhe duke garantuar transparencë përgjatë gjithë procesit zgjedhor, ishte mjeti më efikas i përcjelljes së informacionit.

Për realizimin me efektivitet të fushatës, u realizua publikimi/transmetimi i informacionit sensibilizues me rotacion të lartë në segmente të shkurtra kohore.



Gjithashtu, u prodhuan dy spote informuese, të cilat u shfaqën në mediat më të rëndësishme të vendit, përfshirë edhe ato lokale.



KOZ, në kuadrin e një fushate edukuese të mirë strukturuar, realizoi informimin e zgjedhësve dhe nëpërmjet mjeteve të shkruara si: postera dhe fletëpalosje, të cilat ofrojnë një informacion më të detajuar dhe të ilustruar, si procedurat që ndiqen nga zgjedhësi në qendrën e votimit, ilustrimin e rasteve të

pavlefshmërisë së votës, të cilat u vendosën në të gjithë qendrat e votimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i kushtoi vëmendje të veçantë edukimit të personave me aftësi të kufizuara. Spotet informuese dhe sensibilizuese, që u shfaqën në media, përfshirë edhe ato lokale, kishin të integruar dhe një person, i cili ilustronte përmbajtjen e spotit me gjuhën e shenjave.

Projekti "Edukimi i zgjedhësve me aftësi të kufizuara për zgjedhjet e përgjithshme 2013", pati risi prodhimin e një fletëpalosje me gjithë informacionin specifik, të nevojshëm, si dhe realizimin e një rubrike në faqen zyrtare të KOZ-së, për t'i ardhur në ndihmë këtij grupi zgjedhësish për çdo lloj paqartësie.

Në zonat ku, referuar të dhënave zyrtare të institucioneve shtetërore ka pakica kombëtare (minoritete), në kuadër të një fushate gjithëpërfshirëse u arrit të realizohen programe informative dhe sensibilizuese si postera dhe fletëpalosje, në gjuhën e tyre.

Ky fakt është theksuar edhe në raportin i OSCE/ODHIR-it, i cili evidenton se "KOZ-ja prodhoi material mbi informimin e zgjedhësve në gjuhët minoritare, i cili u shpërnda në vendndodhjet e QV-ve, ku ishin të përqendruar minoritetet greke, vllahe, malazeze, serbe dhe maqedonase".

Krahasuar me zgjedhjet e vitit 2009, kjo pjesë e fushatës edukuese u shtri, në mënyrë të fokusuar, në të gjitha komunitetet e minoriteteve.

Targetimi efektiv i të rinjve dhe sidomos i atyre që votojnë për herë të parë u realizua nëpërmjet prodhimit dhe shpërndarjes të 2 mijë posterave, si dhe publikimit

të informacioneve, në mënyrë të vazhdueshme, në internet dhe rrjetet e tjera sociale, si burime më të përdorura dhe më të besueshme.

Në këtë kuadër, u organizuan takime informuese me të rinjtë ku u prekën tema që janë me interes për çështjet zgjedhore, veçanërisht për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në votime, e shprehur qartë edhe në moton e KQZ-së në këto zgjedhje **“Vota jote vlen, voto edhe ti”**.

Prezantimi i të gjitha veprimeve në qendrën e votimit, në formën e një pyetësi gjeti interesin e të rinjve. Gjithashtu, Zyra e Këshillit të Evropës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit e Shkencave dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve zbatoi në shkollat e mesme të vendit projektin “Fushata e ndërgjegjësimit të votuesve për herë të parë”, i cili pati ndikim në informimin dhe nxitjen e të rinjve për të marrë pjesë në votim, si dhe për të sensibilizuar bashkëmoshatarët apo familjarët e tyre.

KQZ realizoi një projekt të veçantë, ku çdo votues i interesuar kishte mundësi që nga faqja zyrtare e internetit të KQZ-së, të vizitonte rubrikën e votimit të distancë nëpërmjet dy komandave “Testo veten”(pyetësor) dhe “Çfarë ndodh në qendrën e votimit”.

Për fushatën sensibilizuese me fokus pjesëmarrjen e grave në votime, u bashkëpunua ngushtë me organizata të ndryshme (si UN Woman), që operojnë në këtë fushë dhe kanë në zbatim projekte të rëndësishme për to. Theksi është vënë në mënyrë të veçantë te rëndësia e votës si një e drejtë individuale duke nënvizuar faktin se votimi familjar, jo vetëm është i ndaluar me ligj, por edhe ndikon në shprehjen e lirë të mendimit të tyre.

A.8 MONITORIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE DHE VËZHGIMI I PROCESIT

A.8.1. Ngritja dhe funksioni i BMM-së

Në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, u miratua Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet KQZ-së dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) për shfrytëzimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të AMA-s, për nevojat e monitorimit të fushatës zgjedhore, në radion dhe televizionin publik dhe privat.

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor referuar dispozitave për Bordin e Monitorimit të Medias, sollën dy elementë të rinj: ngritjen e Bordit të Monitorimit të Medias 40 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore; dhe detyrimin e KQZ-së për të përzgjedhur



kandidaturat për anëtar të BMM-së, të propozuar nga Organizatat jo Fitimprurëse të cilat operojnë në fushën e Medias, lista e të cilave duhej të sigurohej nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sigurimi i informacionit për OJF-të nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë pati vështirësi për shkak të mungesës së regjistrimit elektronik. Për me tepër, komunikimi me OJF-të e kontaktuar nga ky burim informacioni, u bllokua pasi adresat e regjistruara në Gjykatë rezultuan të pasakta ose të gabuara. Për të zgjidhur këtë ngërç, KOZ bëri njoftim publik, duke iu drejtuar të gjithë OJF-ve të interesuara që veprojnë në fushën e medias.

Me gjithë vështirësitë, Bordi i Monitorimit të Medias u ngrit me strukturë të plotë dhe në zbatim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, pavarësisht dorëheqjes nga detyra të 3 anëtarëve të KOZ-së.

BMM depozitoi në KOZ çdo ditë raportet ditore dhe tre raporte javore duke propozuar dhe masat. Raporti i tretë nuk u shqyrtua në seancë publike për arsye të problemeve të komunizmit ndërmjet anëtarëve të BMM-së. Propozimet e paraqitura në raportet e BMM-së, u shqyrtuan çdo javë nga KOZ, e cila vendosi rast pas rastit pranimin e tyre dhe kompensimin në favor të subjektit zgjedhor, si dhe urdhëroi operatorët audiovizivë për korrigjimet e duhura në qartësimin e subjektit zgjedhor në shfaqjen e reklamave. Një pikë domethënëse e këtij procesi është caktimi nga KOZ i një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 5 minutash përkatësisht në Televizionin dhe Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore për secilin prej dy kandidatëve të pavarur, z. Dritan Prifti dhe z. Arben Malaj.

Ajo që u konstatua ishte fakti se BMM nuk arriti të gjente mënyrën për t'ua bërë me dije konstatimet e raporteve subjekteve transmetuese, në mënyrë që të ushtronin të drejtat e tyre në procedimin administrativ. Megjithatë, kjo situatë u korrigjua në nëpërmjet informimit të subjekteve transmetuese me anë të vënies në dispozicion të raporteve të BMM-së me anë të postës elektronike.

Aktivitetet e subjekteve zgjedhore gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, u pasqyruan në tërësi me profesionalizëm, por pavarësisht këtij fakti, u vunë re dhe disbalancime në kohë, në favor të dy koalicioneve më të mëdha, duke mos respektuar pjesërisht përcaktimet e Kodit Zgjedhor.



A.8.2. Regjistrimi i vëzhguesve vendas dhe të huaj

Rregullimi ligjor përsa i përket rolit të vëzhguesve por dhe të medias në monitorimin e procesit zgjedhor në Shqipëri përfaqëson me standartet ndërkombëtare në këtë drejtim.

Shqipëria, si anëtare e OSBE por dhe organizatave të tjera ndërkombëtare ka përmbushur në një masë të vlerësueshme detyrimin për të garantuar vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues ndërkombëtar dhe vendas (bazuar edhe në artikullin 7 të dokumentit të Kopenhagut të 1990).


Akreditimi i vëzhguesve vendas dhe të huaj, u bazua në Udhëzimin e KOZ Nr. 13, datë 22.04.2009 "Mbi përcaktimin e rregullave të vëzhgimit të procesit zgjedhor, akreditimit, të drejtat dhe detyrat, kriteret dhe standartet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga organizatat jofitimprurëse shqiptare, organizmat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave".

Subjekteve të akredituara (vendase dhe të huaja) iu vunë në dispozicion një set i plotë dokumentacioni në funksion të realizimit dhe lehtësimit të misionit të tyre, siç janë:

- Vendimet dhe udhëzimet e KOZ-së;
- Përmbajtjen e fletëve të votimit dhe tabelave të rezultateve;
- Të dhëna për KZAZ-të dhe VNV-të (përmbajtja dhe vendndodhja);
- Të dhëna për QV-të;

Përveç këtij dokumentacioni, KOZ përgatiti në gjuhën shqipe dhe angleze një Udhëzues praktik, të orientuar kryesisht për vëzhguesit e huaj. Udhëzuesi jepte njohuritë thelbësore për sistemin dhe procesin zgjedhor në Shqipëri, si dhe përmbledhite informacion të përgjithshëm për Shqipërinë.

Kemi konstatuar me kënaqësi, se kjo paketë informuese ka ndihmuar në realizimin e misionit të vëzhgimit dhe në kuptimin më të drejtë të specifikave të procesit zgjedhor në Shqipëri.



Zgjedhjet e 23 qershorit, krahasuar me zgjedhjet e mëparshme, u vëzhguan nga një numër shumë më i madh organizatash jo qeveritare, organizma ndërkombëtare, përfaqësi diplomatike në Shqipëri dhe media. E pasqyruar në shifra, janë akredituar gjithë **9,538**, nga të cilët **8,469** vëzhgues vendas dhe përfaqësues të

medias dhe **1,069** vëzhgues të huaj.

Prezenca e një numri kaq të madh vëzhguesish rriti transparencën ndaj procesit dhe besimin në integritetin e procesit zgjedhor.

A.9 PËRGATITJA DHE DORËZIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE DHE DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR NGA KQZ NË KZAZ DHE NGA KZAZ NË KQV

Materiali zgjedhor që përdoret nga KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të për procesin zgjedhor, sipas përcaktimeve të specifikuara qartë në Kodin Zgjedhor, u shpërnda në kohë, me gjithë vështirësitë që ky proces ka në jo pak raste për shkak të distancave dhe infrastrukturës rrugore. Organizimi i mirë i punës nga KQZ, në bashkëpunim me KZAZ-të dhe Zyrat Rajonale, rezultoi funksionale dhe produktive. Në këtë kuadër, ndihmoi vënia në dispozicion të inspektorëve rajonale dhe sekretarëve të KZAZ-ve të numrave celularë brenda një rrjeti/grupi komunikimi të brendshëm me KQZ-në, sipas një numërtimi logjik i cili i korrespondonte numrit të KZAZ-së.

Logjistika Zgjedhore funksionon mbi bazën e një sistemi të centralizuar të organizimit, përpunimit, transportit dhe mbledhjes së dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore. Për shkak të afateve ligjore që përcakton Kodi Zgjedhor, sigurimi dhe përpunimi i materialit zgjedhor brenda një kohe shumë të shkurtër mbetet një problem me të cilin KQZ përballlet në çdo proces zgjedhor. Për përmbushjen e detyrave të saj, ajo u mbështet në burime dhe institucione që kanë mundësi të garantojnë një infrastrukturë të tillë, siç është Posta Shqiptare dhe Ministria e Mbrojtjes.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë të urdhërimeve dhe afateve kohore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, nëpërmjet gjithë administratës realizoi me sukses shpërndarjen e materialeve zgjedhore dhe fletët e votimit në 89 Zonat e Administrimit Zgjedhor. Duhet theksuar se respektimi i këtij afati erdhi si rezultat i planifikimit në kohën e duhur të infrastrukturës së logjistikës zgjedhore dhe të bazuar në një sistem të organizuar dhe jo rastësor, duke garantuar një standard të përmirësuar të përgatitjes dhe administrimit të logjistikës zgjedhore.

Çdo Komision Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe Komision i Qendrës së Votimit (KQV) patën në dispozicion në afatin ligjor të gjithë dokumentacionin dhe materialet zgjedhore të domosdoshme për zbatimin e procedurave dhe përmbushjes së detyrave që Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, iu ngarkon këtyre komisioneve. Sigurisht që i gjithë ky proces është kryer falë një bashkëpunimi shumë pozitiv të Ministrisë së Mbrojtjes që vunë në dispozicion mjetet e transportit, si dhe Policinë e Shtetit për shoqërimin e materialeve zgjedhore në të gjitha destinacionet.

KQZ ka ndjekur të gjithë procesin e shpërndarjes së materialeve zgjedhore nga KZAZ-të tek Komisionet e Qendrave të Votimit, si dhe ka dhënë ndihmën teknike për të zgjidhur të gjitha situatat apo "bllokimet" e krijuara artificialisht si pasojë e tensionit dhe ngarkesës së punës që mbartin 24 orët e fundit para ditës së votimit. Emërimet e komisionerëve të QV në tejkallim të skajshëm të afatit ligjor (në orët e fundit të datës 22 qershor) ndikuan negativisht edhe në procedurat e shpërndarjes së bazës materiale. Ky është një tjetër moment që mund të shërbejë si indicie për reflektim ligjor dhe qytetar nga të gjithë aktorët në përmirësim të këtij procesi.

B. PROCESI I VOTIMIT, NUMËRIMI DHE NXJERJA E REZULTATIT

B.1 DITA E ZGJEDHJEVE

Procesi dhe dita e zgjedhjeve në tërësi ka qenë pa dyshim standardi më demokratik i realizuar, jo vetëm nga administrata zgjedhore por edhe nga qytetarët shqiptarë, të cilët treguan një interes dhe pjesëmarrje të dukshme në rritje ditën e zgjedhjeve. Procesi i votimit u zhvillua në 5.507 QV nga 5.508 QV të ngritura në të gjithë territorin e vendit. Në Njësinë Bashkiake nr. 1 në Tiranë, Bashkinë Bulqizë, Komunën



Kodër-Thumanë dhe Komunën Sevaster, krahas zgjedhjeve për Kuvend, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetar të njësive të qeverisjes vendore.

Për këto zgjedhje u regjistruan 3,271,885 votues, nga të cilët, bazuar në raportin e publikuar për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, kanë votuar gjithsej 1,749,358 (e shprehur në përqindje 53.47% e zgjedhësve).

Në përgjithësi qendrat e votimit u hapën në orarin e përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Administrimi i problematikës së ditës së zgjedhjeve nga KQZ konsistoi vetëm në zgjidhjen e problemeve me natyrë teknike të identifikuar në disa QV të largëta, shkaktuar këto nga infrastruktura e vështirë, në disa raste dhe për shkak të kushteve atmosferike. Më konkretisht, u identifikua dëmtimi i kutive të votimit gjatë transportit në 5 QV, ose 0.1% të QV-ve në rang vendi, të cilat u zëvendësuan menjëherë. Rastet problematike, u zgjidhën me objektivitet dhe në kohë rekord, duke plotësuar çdo mangësi të evidentuar me qëllim garantimin e ecurisë normale dhe të qetë të procesit në çdo QV. Vetëm në një rast, u raportua nga KZAZ-ja nr. 46, qarku Elbasan për QV-në nr. 2547, në Komunën Mollas, mungesa e fletëve të votimit në momentin e hapjes së qendrës së votimit. Fakti i konstatuar dhe i verifikuar si nga KZAZ-ja dhe Inspektori Rajonal i KQZ-së i kaloi organeve të policisë dhe ndërkohë KQZ, me vendim nr. 636, datë 23.6.2013 nxori jashtë përdorimit të gjitha fletët e votimit për këtë QV dhe bëri plotësimin e numrit të nevojshëm të tyre duke përdorur sasinë rezerve të fletëve të votimit të shtatë QV-ve të së njëjtës Zonën Zgjedhore.

Gjatë ditës së votimit, KQZ disponoi me vendim nëntë raste të zëvendësimit të vulave për shkak të "dëmtimit", "humbjes", apo largimit të komisionerëve nga QV së bashku me vulën. Numri në rritje i rasteve të zëvendësimit të vulës me vulë rezervë, në krahasim me zgjedhjet e viteve pararendëse, nuk mund të konsiderohet si trend në rritje i këtij fenomeni, që në thelb të tij është shqetësues. Kjo për faktin se në zgjedhjet e 23 qershorit, ky fenomen lidhet me incidentin e rëndë të ndodhur në qarkun Lezhë, afër vendodhjes së katër QV-ve.

Nga ana procedurale, Kodi Zgjedhor dhe Vendimi i KQZ-së për administrimin e vulave rezervë, duke i parapërgatitur ato dhe vënë në disponim të Inspektorëve Rajonalë me qëllim shpërndarjen nëq rast do ta kërkonte, i parapriu çdo situatë të mundshme duke parashikuar dhe opsionet e zgjidhjes, pa cënuar vlefshmërinë e procesit të votimit në një qendër votimi.



Një problem tjetër, me të cilin KOZ u përball gjatë ditës së votimit ishte edhe tejmbushja e kutive të votimit për shkak të përmasave shumë të mëdha të fletës, por edhe përdorimit të kutisë së materialeve zgjedhore si kuti votimi, kapaciteti i së cilës është i pamjaftueshëm. Një situatë e tillë ishte parashikuar nga KOZ që në fazën e përgatitjes së infrastrukturës dhe materialeve për KOZ-të dhe me vendim nr. 506, datë 05.06.2013, u miratua numri i kutive të votimit rezervë që u administruan paraprakisht nga çdo KZAZ.

Institucionet e posaçme si burgjet apo spitalet, në këto zgjedhje ishin të pajisura me numrin e saktë të fletëve të votimit dhe vetëm në një rast, në QV-në Nr. 2113, Burgu Vaqarr, u kërkua një sasi prej 35 fletësh votimi shtesë për zgjedhësit të cilët ishin pajisur me vendim gjykate. Këtë rast, KOZ me efikasitet, e disponoi me Vendimin e saj Nr. 641 dhe 642, duke autorizuar KZAZ-në të ndërmerre veprimet e duhura, plotësimin e sasive të fletëve të votimit të munguara me fletë të një qendre votimi të po kësaj KZAZ-je me vendodhje të afërt.

Problem i evidentuar gjatë procesit të votimit, i cili u shndërrua në tipologji të ditës së votimit në këtë proces zgjedhor, ishte pengesa/moslejimi për të votuar, i zgjedhësve femra të cilat kishin mbiemrin e marrë pas martesës/divorcit në listën e zgjedhësve, i cili "dëshmonte" një identitet të ndryshëm nga sa pasqyrohej në dokumentin e identitetit. Kanë qenë të shumta ankesat e adresuara si në KOZ ashtu edhe në Zyrat Rajonale në lidhje me këtë çështje ditën e zgjedhjeve. Ky problem, i shfaqur dhe në zgjedhjet e kaluara të vitit 2011 por në raste të pakta pasi zgjedhësit sapo ishin pajisur me dokumente të identifikimit (karta e identitetit dhe pasaporta biometrike). Ky fenomen ka qenë shumë shqetësues në Qarkun e Tiranës ku kanë qenë të shumta rastet kur zgjedhëset femra me mbiemër të ndryshuar pas aplikimit për dokument identifikimi, nuk u lejuan të votojnë ose u lanë në pritje të marrjes së një konfirmimi nga KZAZ-ja, të cilat në raste të ndryshme kanë ndjekur standarde të ndryshme. Komunikimi i strukturave të KOZ-së me të gjitha KZAZ-të, përmirësoi gjendjen rreth orës 14.00, ku thuajse nuk kishte më KOZ të cilat pengonin për të votuar këtë kategori zgjedhësish të cilat ishin pajisur me vërtetim apo certifikatë e cila vërtetonte ndryshimin e mbiemrit.

Të shumta kanë qenë edhe informacionet e kërkuara nga KOZ-të dhe KZAZ-të në lidhje me lejimin apo jo të atyre zgjedhësve me banim jashtë vendit të cilët kërkonin



të votonin me pasaportat e një vendi të huaj, të evidentuara më së shumti në Qarkun e Korçës.

Votimi u mbyll në orarin e përcaktuar në ligj në të gjitha qendrat e votimit, përveç rastit të QV-së nr. 2113, Burgu Vaqarr, ku votimi u vazhdua përtej orës 19.00 për shkak të vonesës së dërgimit të fletëve të votimit shtesë.

Në këto zgjedhje kanë qenë shume të rralla rastet e zgjedhësve të cilët nuk ishin në listën e zgjedhësve apo të cilët kishin patur probleme më gjetjen e qendrës së tyre të votimit. Në të gjitha rastet fluksi i zgjedhësve në qendrat e votimit ka qenë i përballueshëm nga komisionet e qendrave të votimit dhe nuk ka patur ankesa për vonesa apo bllokime të zgjatura dhe të qëllimshme të procesit. Nga kontaktet e marra me KZAZ-të dhe anëtarë të KQV-ve, të gjitha modelet tip apo procesverbalet e KQV-së, ishin lehtësisht të kuptueshëm dhe të thjeshtë për t'u plotësuar. Për qetësinë dhe rregullin e ecursisë së procesit të votimit në këto zgjedhje, dëshmon dhe mungesa totalisht e referimeve të problematikave nga partitë politike gjatë ditës së zgjedhjeve.

Konkretisht gjatë ditës së zgjedhjeve, 23 qershor 2013, në KQZ janë paraqitur:

- dy kërkesa nga dy subjekte zgjedhore, AK dhe PBDNJ, që nuk kanë patur objekt problematika të evidentuara apo kërkesë për ndërhyrje të KQZ-së me autoritetin e vet ligjor;
- një kërkesë nga KZAZ 15, qarku Lezhë;
- tre raste njoftimi për probleme humbjes së vulës.

Pavarësisht nga momentet e problemeve sporadike, të cilat janë normale në një ditë zgjedhjesh të përgjithshme, dita e votimit dëshmoi një standard pozitiv, të vlerësuar kështu jo vetëm nga KQZ, por edhe nga faktorët ndërkombëtarë sikundër dhe nga aktorët dhe faktorët vendas, pjesë e këtij procesi zgjedhor. Për sa i përket zbatimit të Kodit Zgjedhor nga komisionet e qendrave të votimit, KQZ konstatoi se përgjithësisht anëtarët e KQV-ve kanë demonstruar profesionalizëm në ushtrimin e detyrës dhe i janë përgjigjur pozitivisht apelit dhe mesazheve të KQZ-së për të respektuar dhe zbatuar Kodin Zgjedhor.



B.2. DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR NË KZAZ, PAS MBYLLJES SË QV-VE. PROCESI I NUMËRIMIT NË VNV DHE NXJERRJA E REZULTATIT NGA KZAZ-TË

Dorëzimi i materialit zgjedhor nga KQV-të në KZAZ u krye korrektësisht dhe në përputhje me afatin ligjor, jo më vonë se tre orë nga mbyllja e votimit, kjo edhe falë mirë përcaktimit të VNV-ve nga KQZ, duke i dhënë përparësi barazlargimit nga qendrat e votimit, sipërfaqes së shfrytëzueshme, vendndodhjes së objektit, sigurisë, kushteve fizike dhe infrastrukturore për vendosjen e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

Në këto zgjedhje, numërimi i votave është bërë nga 940 grupe numërimi, në mënyrë të përqendruar në 89 vende numërimi të votave (VNV), me vendndodhje kryesisht palestra. Përpara fillimit të procesit të numërimit të votave u organizuan sesione të shkurtra trajnimi me anëtarët e grupeve të numërimit, për shkak të emërimeve të minutës së fundit. KQZ prodhoi dhe vuri në dispozicion të GNV-ve, ndarëse prej kartoni të cilat shërbyen për sistemimin e fletëve të votimit sipas subjekteve, element që u përdor për herë të parë në këto zgjedhje dhe i shërbeu lehtësimit të punës gjatë numërimit. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes KQZ-së dhe CEZ shpërndarje sh.a, u bë i mundur sigurimi i pandërprerë i energjisë elektrike për të gjitha VNV-të. Gjithashtu, në bashkëpunim me Albtelecom-sh.a, u bë e mundur lidhja telefonike me të gjitha VNV-të.

Ndërprerjet e procesit të numërimit në më të shumtën e rasteve u evidentuan në KZAZ-të të cilat kishin shumë qendra votimi në juridiksionin e tyre, pra edhe më shumë votues. Në këto KZAZ, ndërprerja ka ardhur si pasojë e lodhjes së komisionerëve të KZAZ-ve dhe të grupeve të numërimit. Shkak tjetër i lodhjes së numëruesve kishte të bënte me faktin se një pjesë e madhe e tyre kishin shërbyer dhe si komisionerë në qendrat e votimit.

Në disa raste procesi i numërimit të votave u ndërpre për të filluar të nesërmen, për shkak të temperaturave shumë të larta dhe në përgjithësi në këto raste procesi i numërimit të votave u krye pasdite dhe në darkë. Megjithatë nuk munguan as rastet kur numërimi rifillonte me vonesë të tejzgjatur dhe të pamotivuar, edhe pas pushimit të caktuar nga KZAZ-ja.



Procesi i numërimit në disa raste u ndërpre për shkak të pranisë të shtuar të vëzhguesve, dhe të presionit që këta vëzhgues ushtronin ndaj grupeve të numërimit dhe anëtarëve të KZAZ-së. Vetëm në dy-tre VNV është kërkuar ndërhyrja e policisë së shtetit për të vendosur rendin pas konflikteve të cilat lindnin ndërmjet vëzhguesve të partive politike, apo ndërmjet vëzhguesve dhe komisionerëve. Megjithatë, në asnjë rast nuk pati braktisje të detyrës gjatë procesit të numërimit, nga komisionerë apo nga anëtarë të grupeve të numërimit. KOZ ka ndjekur në dinamikë procesin, dhe ka ushtruar gjithë autoritetin që i jep ligji për ecurinë në kohë të tij.


Tabelat e rezultateve për çdo qendër votimi të dërguara nga KOZ ishin me letër karboni dhe në numrin e saktë të qendrave të votimit. Gjatë punës grupet e numërimit dëmtuan disa tabela rezultatesh të cilat bëheshin automatikisht të papërdorshme. Për të mos penguar ecurinë e procesit, KOZ orientoi KZAZ-të që në rastet e demtimit, të përdornin tabela rezultatesh të fotokopjuara, me vulën e KZAZ-së, dhe ky fakt të pasqyrohej në Librin e Protoollit të KZAZ-së. Ndërkohë, KOZ mori të gjitha masat dhe në një kohë rekord prodhoi dhe shperndau tabela shtesë të rezultateve për ato KZAZ-të të cilat kishin raportuar këtë problematikë.

Rritja e numrit të KZAZ-ve si dhe përmirësimet ligjore për mos hapjen e kutisë së materialeve zgjedhore në rast se ndodhej procesverbali i mbylljes së QV-së në kutinë e votimit, reflektuan në uljen e ndjeshme të bllokimeve të procesit nga KZAZ-të apo GNV-të.

Në krahasim me zgjedhjet e kaluara në të gjitha KZAZ-të u ul ndjeshëm edhe numri i votave të pavlefshme. Kjo erdhi si pasojë e një fushate edukuese qytetare të ndërmarrë nga KOZ, por edhe qartësimeve nëpërmjet Vendimit Nr. 172, datë 27.02.2013 të KOZ "Për unifikimin e praktikës së vlerësimit të fletëve të votimit nga personat e ngarkuar nga Kodi Zgjedhor, për numërimin dhe vlerësimin e votave". Ky vendim, përveçse bëri të mundur uljen e ndjeshme të votave të pavlefshme (nga **46.615**, në zgjedhjet e kaluara në **24.181**, në këto zgjedhje), bëri të mundur edhe parandalimin e shumë debateve, vonesave dhe bllokimeve të procesit të cilat vinin si pasojë e mos mbajtjes së një standardi vlerësues nga KZAZ-të.



Në këndvështrim statistikor, nqs do të krahasojmë të dhënat nga zgjedhjet e vitit 2000 deri në zgjedhjet e vitit 2013, do të vemë re një rënie të dukshme të përqindjes së votave të pavlefshme, - nga 6.73% në 1.39%. Ky përmirësim ka ardhur si rezultat i përmirësimeve të vazhdueshme të praktikës zgjedhore, trajnimit të komisionerëve dhe edukimit të zgjedhësve.



Në përgjithësi procesi i numërimit të votave shkoi shumë mirë. Siguria në Vendet e numërimit të votave ka qenë në të gjitha rastet në lartësinë e kërkuar dhe puna e bërë nga Policia e Shtetit ka qenë shumë e mirë.

Gjatë procesit të numërimit vetëm KZAZ nr. 89, mori vendim për të mos numëruar 2 kuti të qendrave të votimi nr. 4719 dhe QV. Nr. 4709, edhe pse ato ishin pranuar si të rregullta. KQZ, në kontroll të plotë të çdo momenti të procesit, menjëherë mori vendim që këto kuti të pranuar të rregullta të numëroheshin, ashtu sikundër përcaktohet në ligjin zgjedhor. Rezultati i tyre u tabulua në tabelën përmbledhëse të kësaj KZAZ-je. Afati ligjor për tabulimet e rezultateve të votimit për ZAZ dhe nxjerrjen e rezultatit, u respektua nga disa KZAZ. Për shkaqet e përmendura më lart, pjesa më e madhe e KZAZ-ve nxorën rezultatin e votimit për ZAZ në tejkalim të afatit ligjor.

B.3 PUBLIKIMI I REZULTATIT PARAPRAK DHE NXJERRJA E REZULTATIT NGA KQZ

Amendimet e Kodit Zgjedhor, sollën si risi edhe konceptin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve për çdo qendër votimi, duke përcaktuar detyrimin e KQZ-së për publikimin në kohë reale të këtij rezultati në faqen e internetit. Në përbushje të këtij detyrimi ligjor, KQZ ngriti një sistem të integruar të administrimit të informacionit zgjedhor, bërthama e të cilit do të ishte moduli i hedhjes, konsolidimit

dhe transmetimit të rezultateve nga VNV-ja në KOZ dhe shfaqja e këtij informacioni në faqen zyrtare të internetit të KOZ-së. Ndryshe nga sistemi i informimit në zgjedhjet e mëparshme, në këto zgjedhje u synua ndërtimi i një sistemi kompjuterik ku jo vetëm të integroheshin të gjitha modulet për administrimin e informacionit zgjedhor por ky sistem të ishte i konsoliduar dhe të shërbente për të gjitha zgjedhjet. Ndërtimi i sistemeve të tilla ka kosto të lartë dhe të papërbalueshëm nga mundësitë buxhetore të KOZ-së. Në këto kushte, KOZ u kërkoi donatërëve dhe partnerëve ndërkombëtarë që e asistojnë, sigurimin e mbështetjes financiare dhe teknike.

Për sigurimin e pajisjeve, sidomos për qendrën e të dhënave, KOZ gjeti mbështetjen e Agjensisë Turke për Kooperimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar, TIKKA (Turkish International Cooperation and Coordination Agency). Falë kësaj mbështetjeje financiare të TIKKA-s u mundësua ndërtimi i rrjetit, pajisja me 2 servera cilësor, 4 kompjutera për administrator e specialistë, 16 kompjutera për operatorët, 4 kamera vëzhgimi dhe një fotokopjues.

Për ndërtimin e "Sistemit të Integruar të Administrimit të Informacionit Zgjedhor", pati një mbështetje të madhe financiare e teknike nga USAID e IFES. Ekspertë të IFES në bashkëpunim me stafin e KOZ-së hartuan projektin përkatës. Ky sistem synon të administrojë në funksion të mirëmanaxhimit dhe transparencës së zgjedhjeve të gjithë informacionin zgjedhor që fillon që nga të dhënat për QV-të, subjektet zgjedhore e listat e tyre shumëmemërore, elemente të logjistikës zgjedhore e shumë informacione të tjera deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në funksion të kohës në dispozicion, bashkëpunimi me IFES deri në zgjedhje nuk arriti të ndërtonte të gjitha modulet e nevojshëm për këtë sistem, për rrjedhojë në këto zgjedhje u zhvilluan modulet më prioritare, si moduli i hedhjes së të dhënave, konsolidimit dhe transmetimit të rezultateve nga VNV-ja në KOZ dhe shfaqja e këtij informacioni në faqen zyrtare të internetit të KOZ-së. Procesi i hedhjes, konsolidimit dhe transmetimit të rezultateve paraprake nga VNV në KOZ u administrua sipas përcaktimeve të aktit të KOZ-së. Rolin kryesor në këtë proces e kishte sekretari i KZAZ-së, i cili mbikëqyrte edhe operatorët e kompanisë që kryen shërbimin teknologjik në VNV. Sekretarët e KZAZ-ve dhe operatorët e nivelit teknik moren trajnimin e duhur respektivisht nga KOZ dhe kompania administruese e këtij sistemi. Shfaqja pothuaj në kohë reale e rezultateve të zgjedhjeve dha mundësi të informimit të shpejtë dhe transparent të publikut me rezultatet e zgjedhjeve.



KQZ, në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, për përgatitjen dhe miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve për çdo zonë zgjedhore, u mbështet në bazën elektronike të të dhënave të rezultatit paraprak, në tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të miratuara nga KZAZ-të, duke bërë korrigjimet sipas tabelave origjinale të rezultateve për çdo QV, në ato raste ku u vunë re mospërputhje të shifrave të pasqyruara në tabelën e rezultateve të ZAZ-së me ato të QV-së.

Në verifikimet e bëra të këtij procesi u pa që një masë e konsiderueshme e 89 tabelave përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-ve të miratuara me vendim të KZAZ-ve përkatëse ishin me gabime (në 89 vetëm 17 KZAZ kishin plotësuar tabelat e rezultateve pa asnjë gabim). KQZ-së iu desh të bëjë një punë voluminoze për të shpejtuar miratimin e TPR të zonave zgjedhore, që sipas kërkesave të Kodit duhet të miratohet me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbëritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore përkatëse.

Puna voluminoze për saktësimin e të dhënave, por edhe koha e kërkuar nga partitë politike për të verifikuar rezultatet e pasqyruara në projekt-aktin e KQZ-së me tabelat e ZAZ-ve dhe QV-ve, solli si pasojë tejkalimin e afatit ligjor për miratimin e Tabelave Përmbledhëse të Rezultatit për çdo zonë zgjedhore, të përcaktuar në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

Duke vlerësuar rendësinë e ndërtimit dhe zhvillimit të moduleve të tjera në funksion të plotësimit të "Sistemit të Integruar të Administrimit të Informacionit Zgjedhor", KQZ mbetet e angazhuar për gjetjen e asistencës teknike dhe financiare.

B.4 RASTE TË SHKELJEVE TË DISPOZITAVE TË KODIT ZGJEDHOR

B.4.1. Shkeljet nga personat e ngarkuar me detyra (kryetar bashkie/komune)

KQZ u vu në vështirësi për krijimin dhe përditësimin e hartave të zonave të qendrave të votimit, si dhe bazës së të dhënave mbi vendndodhjen e qendrave të votimit, për shkak të mos përmbushjes së detyrave ligjore nga një numër i konsiderueshëm i kryetarëve të njësive të organeve të qeverisjes vendore.

Shkeljet e evidentuara konsistojnë në: 1. Mos-respektimin e afatit ligjor për dërgimin e informacionit; 2. Dërgimin e informacionit jo sipas kërkesave ligjore; dhe 3. Mos dërgimin e asnjë lloji informacioni për sa i ngarkon Kodi Zgjedhor.

Në vlerësim të rëndësisë së realizimit në kohë dhe në përputhje me standardet e kërkuara ligjore të këtij procesi, KOZ fillimisht adresoi shkresërisht e më pas publikisht, në mënyrë të detajuar dhe përsëritur, kërkesën për dërgimin e të dhënave të kërkuara nga ligji. Për më tepër, në rolin e saj bashkëpunues, KOZ ofroi asistencë permanente për mënyrën e përgatitjes dhe plotësimin e të dhënave gjatë gjithë këtij procesi.

KOZ, jo vetëm në zbatim korrekt të ligjit, por edhe për ta kthyer situatën në parametrat e kërkuara, në mbështetje të nenit 169, nenit 171 pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" vendosi sanksione administrative me gjobë për 139 kryetarë të njësive të organeve të qeverisjes vendore të cilët nuk zbatuan dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Roli aktiv i KOZ-së, përmirësoi dukshëm situatën dhe detyroi të gjithë personat përgjegjës që të shlyenin sanksionet administrative të vendosura ndaj tyre.

Megjithëse në tejkalim të afatit ligjor KOZ, në vlerësim të shqetësimeve të ngritura nga subjektet zgjedhore për sa i përket plotësimin të kriterëve ligjore për vendndodhjen e disa QV-ve, si dhe pas verifikimeve të pretendimeve të ngritura, disponoi me vendimet përkatëse ndryshimin e vendndodhjeve të një numri jo të vogël qendrash votimi. Duhet theksuar se, shkeljet e kryetarëve të njësive vendore në këto raste konsistonin kryesisht në:

- caktimin e QV-së jashtë territorit të zonës së qendrës së votimit;
- caktimin e QV-së në ambient privat, i cili më parë kishte shërbyer si ambient elektorale;
- caktimi i QV-së në një vendndodhje të ndryshme nga zgjedhjet pararendëse;
- caktimi i QV-së në një ambient privat, pronari i të cilit ishte në konflikt me banorët e zonës së qendrës së votimit, etj.

Rasti më tipik i i shkeljeve të detyrimeve ligjore, ishte ai i kryetarit të Komunës Kala e Dodës, i cili jo vetëm nuk dërgoi informacion në KOZ, por deri në përfundim të këtij procesi ndryshoi edhe vendndodhjen e qendrave të votimit, duke shkelur në mënyrë flagrante dispozitat e Kodit Zgjedhor. Për këtë rast KOZ bëri kallzim penal në organin e Prokurorisë së rrethir Gjyqësor Peshkopi.



B.4.2. Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal nga komisionerët e niveleve të dyta dhe të treta


Në momentin e dorëzimit të materialeve zgjedhore nga KZAZ-të në KOZ, u konstatua se në tabelat e rezultateve origjinale të QV-ve të plotësuara nga grupet e numërimit të KZAZ-së nr. 13, kishin dukshëm korrigjime, fshirje të shifrave të tabeluara për disa subjekte zgjedhore, shtuar faktin që letra dhe modeli i tabelës së rezultateve nuk ishin në llojin dhe formatin e miratuar nga KOZ.

Në zbatim të nenit 123 të Kodit Zgjedhor, KOZ verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhore. Gjatë hartimit të tabelës përmledhëse të rezultateve për zonën zgjedhore qarku Lezhë, KOZ verifikoi mospërputhjen e shifrave të votave për disa subjekte zgjedhore në tabelat e rezultateve të QV-ve me rezultatet e hedhura në sistem, e më pas të vet tabelës së rezultateve të ZAZ -së nr. 13, qarku Lezhë.

Në vlerësim të këtyre fakteve, KOZ shpalli rezultatin e zgjedhjeve për zonën zgjedhore qarku Lezhë, në bazë të rezultateve të tabelave të rezultateve të hedhura në sistem, duke ndryshuar në këtë mënyrë tabelën përmledhëse të rezultateve të ZAZ-së 13 qarku Lezhë.

Mbi bazën e ankimit të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike, KOZ thelloi hetimin administrativ, duke këqyrur fletët e votimit të ndodhuara në 10 kutitë e votimit të QV-ve të ZAZ-së nr. 13, qarku Lezhë. Nga këqyrja e materialit zgjedhor, si gjatë procedimit administrativ në KOZ, ashtu dhe gjatë gjykimit në Kolegjin Zgjedhor, u provua se rezultati i zgjedhjeve në këto 10 qendra votimi ishte i ndryshëm nga ai i tabelave të dorëzuara nga KZAZ-ja nr. 13 në KOZ.

Faktet e provuara dëshmuar se anëtarët e KZAZ dhe anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave përkatëse, kishin shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor duke konsumuar elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 326 i Kodi Penal për falsifikimin e materialit zgjedhor dhe rezultatit të zgjedhjeve. Për të gjithë komisionerët përgjegjës, KOZ, me vendim nr. 773, datë 09.08.2013, bëri kallzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë.



Gjithashtu, për 5 (pesë) komisionerë të QV-ve, të KZAZ-së nr. 15, qarku Lezhë, me detyra Kryetar apo Sekretar të KQV-së, të cilët, gjatë procesit të votimit braktisën detyrën duke marrë me vete dhe vulat Kryetarit/KQV-së, duke konsumuar kështu elemente të veprës penale të parashikuar nga neni 330/a i Kodit Penal braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve zgjedhore duke marrë me vete apo duke zhdukur dhe materialin zgjedhor.

B.4.3. Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga subjektet zgjedhore

Në procesin e verifikimit të listave shumëmemërore të kandidatëve për deputet për Kuvend, u konstatuan se 3 (tre) parti politike nuk kishin respektuar kriterin e gjinisë, përkatësisht: Partia Socialiste në 6 (gjashtë) zona zgjedhore, Partia Demokratike në 4 (katër) zona zgjedhore dhe Lëvizja Socialiste për Integrim në 4 (katër) zona zgjedhore. Megjithë evidentimin dhe njoftimit për mos zbatim të kriterit gjinor, nga këto subjekte zgjedhore nuk u shfrytëzua e drejta e plotësimit/korrigjimit të listave shumëmemërore sipas përcaktimeve dhe afateve të Kodit Zgjedhor.

KQZ, në mbështetje të nenit 67, 175 të Kodit Zgjedhor për subjektet zgjedhore të sipërpërmendura të cilat nuk respektuan kriterin gjinor vendosi sanksione administrative përkatësisht në vlerën 6 milion lekë për PS, 4 milion lekë për PD dhe 4 milion lekë për LSI.

C. ANKIMET NË RRUGË ADMINISTRATIVE DHE NË KOLEGJIN ZGJEDHOR

C.1 ANKIMET ZGJEDHORE NË KQZ

Në zgjedhjet për Kuvend 2013 u deponua një numër relativisht i madh kërkesash ankimore, gjithsej 41. Jo vetëm partitë e mëdha, por dhe një numër i konsiderueshëm i partive të vogla ushtruan të drejtën e tyre ligjore për të kundërshtuar rezultatin e zgjedhjeve në një apo në të gjitha zonat zgjedhore. Si rrjedhojë e njohjes me vonesë e formateve të standartizuara e të miratuara nga KQZ (modeli i kërkesës ankimore), u kthyen për plotësim një pjesë e madhe e kërkesave, të cilat nuk plotësonin elementët e formës, të cilat kryesisht ishin paraqitur nga partitë e reja. Mangësitë e konstatuara u plotësuan u plotësuan, falë edhe konsulencës dhe ndihmesën së dhënë nga KQZ.



Nga 41 ankimet e paraqitura:


- 30 ankime kanë si objekt "Kundërshtimi i vendimit të KQZ-së: "Për miratimin e tabelës Përmbledhëse të rezultateve:
- 1 ankim ka si objekt "Kundërshtimi i vendimit të KZAZ-së": "Për miratimin e Tabelave përmbledhëse të rezultateve";
- 10 ankime kanë si objekt "Kundërshtim të vendimit të KZAZ-ve dhe KQZ-së": "Për nxjerrjen e rezultateve" dhe shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve;

Nga të cilat:

- Për 10 ankime, procedimi administrativ nuk vazhdoi, pasi subjektet e interesuara e adresuan çështjen në Kolegjin Zgjedhor (ankimet për zonat zgjedhore Lezhë dhe Shkodër);
- Për 29 ankime u vendos rrëzimi i kërkesës ankimore dhe lënia në fuqi e vendimit të KQZ-së;
- Për 2 ankime u vendos pushimi i shqyrtimit të kërkesës ankimore.

Kërkesa ankimore të paraqitura nga Subjektet Zgjedhore		
Subjekti Zgjedhor	Numri i Kërkesave Ankimore	Vendimi i KQZ-së
Partia Socialiste (PS)	1 (një)	shqyrtimi nuk përfundoi
Partia Demokratike (PD)	2 (dy)	1 e rrezuar 1 e pushuar, pasi ankuesi hoqi dorë
Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK)	2 (dy)	1 u rrëzua 1 shqyrtimi nuk përfundoi
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	1 (një)	u rrëzua
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ)	1 (një)	1 e pushuar, pasi ankuesi hoqi dorë
Partia Republikane (PR)	2 (dy)	1 mos pranimit për shqyrtim 1 shqyrtimi nuk përfundoi
Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë (PBPPSH)	7 (shtatë)	5 u rrëzuan 2 shqyrtimi nuk përfundoi
Partia Aleanca Kuq e Zi (AKZ)	1 (një)	u rrëzua
Partia Popullore Kristian Demokrate	13 (trembëdhjetë)	10 u rrëzuan 2 shqyrtimi nuk përfundoi 1 mos pranua për shqyrtim
Partia Ardhmëria Shqiptare (PASH)	1 (një)	u rrëzua

Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane	8 (tetë)	8 u rrëzuan
Partia Demokristiane e Shqipërisë	1 (një)	u rrëzua
Kandidat i mbështetur nga Zgjedhësit, Z. Dritan Prifti	1 (një)	u rrëzua



Në disa raste kërkesat ankimore ishin të paqarta të pabazuara në ligj, në asnjë fakt dhe provë, kryesisht ato të paraqitura nga Partia Popullore Kristian Demokrate, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë dhe Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane. Shqyrtimi i tyre ishte harxhim kohe energjie, dhe në mënyrë artificiale, vonuan shpalljen e rezultetit përfundimtar të zgjedhjeve.

KQZ, në procesin e shqyrtimit të kërkesave ankimore, u investua duke thelluar hetimin administrativ për të evidentuar, siguruar dhe këqyrur çdo provë të nevojshme për zgjidhjen sa më të drejtë dhe në transparencë të plotë të çdo çështjeje, pavarësisht mungesës së kuorumit të trupës së KQZ-së, Kolegji Zgjedhor e konstatoi të pavlefshme këtë vendimmarrje.

C.2 ANKIMET KUNDËR VENDIMEVE TË KQZ-SË TË PARAQITURA NË KOLEGJIN ZGJEDHOR

C.2.1. Ankimet para zgjedhore të paraqitura në kolegjin zgjedhor

Në periudhën para datës së zgjedhjeve janë paraqitur në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë gjithsej 16 kërkesa ankimore:



Nga të cilat:

- 1 ankim me objekt "Kundërshtimin e vendimit të KOZ-së për mos ndarjen e ZAZ dhe shqyrtimin e çështjes në themel nga Kolegji dhe ndarjen e ZAZ sipas kërkesës";
- 6 ankime me objekt "Kundërshtimin e vendimit të KOZ-së regjistrimin e partive si subjekte zgjedhore";
- 1 ankim me objekt "Kundërshtimin e vendimit të KOZ-së për përbërjen e KZAZ-ve";
- 1 ankim me objekt "Kundërshtimin e vendimit të KOZ-së për regjistrimin e listave shumëmemërore dhe vendosjen e gjobës për mosrespektimin e kriterit të gjinisë";
- 1 ankim me objekt "Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të KOZ-së për materialet që lejohet të përdoren nga anëtarët e KOV-së ditën e votimit";
- 6 ankime me objekt "Kundërshtimin e vendimit të KOZ-së për përcaktimin e vendndodhjeve të qendrave të votimit".

Për të cilat:

- Për 8 ankime u vendos pranimi i kërkesë padisë dhe ndryshimi pjesërisht i vendimit të KOZ-së;
- Për 1 ankim u vendos pushimi i gjykimit;
- Për 7 ankime është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë.

C.2.2. Ankimet pas zgjedhore të paraqitura në Kolegjin Zgjedhor

Numri i ankimeve parazgjedhore të shqyrtuara nga Kolegji Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë është **23** çështje.

Nga të cilat:


- 6 ankime me objekt "Kundërshtimin e vendimit të KOZ-së për nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse";
- 3 ankime me objekt "Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të KOZ-së;
- 12 ankime me objekt "Për mosmarrjen e vendimit nga KOZ për ndarjen e mandateve në bazë të nenit 162 dhe 163";
- 2 ankime me objekt "Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të KOZ-së për shqyrtimin e kërkesave ankimore".



Për të cilat:

- Për **4** ankime u vendos rrëzimi i kërkesë padisë dhe lënia në fuqi e vendimeve të KQZ-së;
- Për **3** ankime u vendos pushimi i çështjes;
- Për **14** ankime u vendos pranimi i kërkesëpadisë;
- Për **1** ankim u vendos pranimi pjesërisht i kërkesë padisë.
- Për **1** ankim u vendos kthimi i kërkesë-padisë

Ankime paszgjedhore të paraqitura nga subjektet zgjedhore në Kolegjin Zgjedhor:		
Subjekti Zgjedhor	Numri i Kërkesave Ankimore	Vendimi i Kolegjit Zgjedhor
Partia Socialiste (PS)	15	2 janë pushuar 13 janë pranuar
Partia Demokratike (PD)	1	është rrëzuar
Partia Demokristiane	1	është rrëzuar
Partia Lëvizja për Zhvillim Komëtar	1	është rrëzuar
Kandidat i mbështetur nga Zgjedhësit, Z. Dritan Prifti	1	është rrëzuar
Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë	1	kthim i kërkesë padisë
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	1	Pranuar
Partia Bashkimi Popullor i Pensionisteve të Shqipërisë	2	1 është pushuar 1 është rrëzuar



D. SHPALLJA E REZULTATIT PERFUNDIMATR TË ZGJEDHJEVE

Pas përfundimit të procesit të votimit, KQZ miratoi rezultatin e votimit për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e Tabelave përmbledhëse të rezultateve të zonave të administrimit zgjedhor dhe Tabelave të rezulttit të qendrave të votimit të plotësuar nga Grupet e Numërimit. Në disa raste, vendimet e KQZ-së për nxjerrjen e rezulttit në zonën zgjedhore u ankimuan në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu në përfundim të shqyrtimeve administrative në KQZ, disa prej vendimeve të KQZ-së u ankimuan në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi bazën e rezulttit të votimit për çdo zonë zgjedhore, në mbështetje të nenit 162 të Kodit Zgjedhor, përllogariti shpërndarjen e mandateve midis koalicioneve zgjedhore dhe partive politike, të cilat garrojnë më vete, për çdo zonë zgjedhore. Në mbledhjen e datës 02.08.2013 me rend dite, miratimi i projekt-akteve të mësipërme, KQZ konstatoi praninë e vetëm 4 anëtarëve të KQZ. Në mbështetje të nenit 22, pika 5 dhe 24, pika 1, germa a, duke qenë se të pranishëm ishin vetëm 4 prej 5 anëtarëve, KQZ konstatoi se mbledhje për miratimin e projektakteve për shpërndarjen e mandateve në zbatim të nenit 162 të Kodit Zgjedhor nuk mund të zhvillohej.

Partia Socialiste e Shqipërisë paraqiti pranë Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë ankimin për mosmarrjen e vendimit nga KQZ, për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore dhe gjykimin në themel të çështjes, duke bërë Kolegji Zgjedhor shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, në zbatim të neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, mbi bazën e rezulttit të votimit për çdo zonë zgjedhore, në mbështetje të nenit 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor, përllogariti shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, si dhe kandidatët fitues për çdo parti politike.

Pas shpalljes së rezulttit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, në mbështetje të nenit 21, pika 8, nenit 2, pika 18 germa a, s dhe nenit 167 të Kodit Zgjedhor, KQZ shpalli me vendimin nr. 759, datë 6.8.2013, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve, i shpallur nga KQZ, përfshin numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo

subjekt në çdo zonë zgjedhore, si dhe numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt zgjedhor në shkallë vendi.

E. BUXHETI I KOZ PËR ZGJEDHJET DHE FINANCIMI I TYRE


E.1 BUXHETI I KOZ-SË PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN 2013

Në bazë të ligjit nr.119, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2013", Komisionit Qendror të Zgjedhjeve iu akordua një fond prej 600 milionë lekësh për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend 2013. Ndryshimet e Kodit Zgjedhor, diktuan nevojën e një infrastrukture zgjedhore të shtuar, realizimi i të cilës do të kërkonte një kosto të shtuar financiare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin nr.174, datë 05.03.2013 "Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23 qershor 2013" miratoi buxhetin për zgjedhjet për Kuvend 2013, duke parashikuar një strukturë buxhetore në shumën totale prej 744 milionë lekë, (nr.zgjedhësve 3.166.097) me kosto për një votues rreth 1.7 euro.

KOZ-ja, në funksion të ngritjes së standarteve zgjedhore, eliminimin e të gjitha dobësive potenciale që mund të shkaktohen gjatë një procesi zgjedhor për shkaqe ekonomiko-financiare, kërkoi shtesë fondi në programin e zgjedhjeve, shtesë e cila u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 323, datë 29.04.2011 dhe VKM nr. 637, datë 31.07.2013, në shumën 85 milion lekë.

Duke analizuar strukturën buxhetore të zgjedhjeve të përgjithshme rezulton se 8.8 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore të personelit të përkohshëm, 29.7 % e fondit është akorduar për pagesën e komisionerëve të të gjitha niveleve, 55.67 % të fondeve është akorduar për shpenzime për mallra dhe shërbime dhe 5.84 % të fondit për investime.



Fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit u përdorën me efikasitet në përputhje me legjislacionin në fuqi për manaxhimin e fondeve publike. Nga 685 milionë lekë të akorduara, u realizuan 676.7 milionë lekë ose 98.79% e fondeve të akorduara. Diferenca prej 8.3 milionë lekësh konsiston në 4.3 milionë lekë në zërin paga për personelin e përkohshëm, dhe 4 milionë lekë në zërin shpenzime për mallra dhe shërbime.

Tabela e fondeve buxhetore të parashikuara & realizuara, zgjedhjet për Kuvendin 2013

					ne mije/leke
-	<u>paga/shperblime</u>	<u>sigurime</u>	<u>mallra/sherbime</u>	<u>investime</u>	<u>totali</u>
fondet e parashikuara	256,951	6,737	381,312	40,000	685,000
fondet e realizuara	254,981	4,559	377,314	39,882	676,735

Pjese e buxhetit të zgjedhjeve për Kuvend 2013, kanë qenë edhe fondet për realizimin e projekteve pilot të teknologjisë, 447 milionë lekë për projektin: verifikimi dhe regjistrimi elektronik i shtetasve në qarkun e Tiranës (SEV) si edhe 232 milionë lekë për projektin: numërimi elektronik në qarkun e Fierit (SEN). Fondet për realizimin e këtyre projekteve iu vunë në dispozicion KQZ-së me VKM nr.372, datë 03.05.2013 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve për Kuvendin të datës 23 qershor 2013". Deri në momentin e vendimarrjes së KQZ-së për mos zbatimin e këtyre dy projekte, në zbatim të kontratave të lidhura me kompaninë përkatëse, u paguan përkatësisht: 164.3 milionë lekë nga 232 milionë lekë për projektin SEN dhe 271.5 milionë lekë nga 447 milionë lekë për projektin SEV. Këshilli i Ministrave me VKM nr. 637, datë 31.07.2013 "Për një ndryshim në VKM nr.372, datë 03.05.2013 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve për Kuvendin, të datës 23 qershor 2013", pakësoi fondet e vëna në dispozicion për këto projekte, me diferencën e papaguar deri në momentin e vendimarrjes së KQZ-së: nga 679 milionë lekë në 436 milionë lekë, për të dy projektet (436 milionë ishin fondet e përdorura për këto projekte deri në momentin e marrjes së vendimit nga KQZ për moszbatimin e tyre).

E.2 FINANCIMI DHE AUDITIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË ZGJEDHJE

Këshilli i Ministrave me VKM nr.485, datë 11.06.2013 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e fushatës zgjedhore të subjekteve përkatëse për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, më 23 qershor 2013", akordoi shumën prej 65 milionë lekësh për t'ju shpërndarë subjekteve zgjedhore pjesmarrëse në zgjedhje.

Ky fond publik u shpërnda partive politike të regjistruara në zgjedhje me vendim nr.495, datë 03.06.2013 "Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që do t'u shpërndahet si paradhënie partive politike të regjistruara si subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23 qershor 2013".

Shpërndarja e fondeve paradhënie për partitë politike të regjistruara si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend 2013, është si më poshtë:			
Nr.	Partitë politike	SHKRONJA NISTORE	Shuma totale e përfutur
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	26,114,596
2	Partia Demokratike	PD	25,688,615
3	Levizja Socialiste per Integrim	LSI	3,100,410
4	Partia Republikane Shqiptare	PR	1,346,157
5	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	PSD	1,123,551
6	Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut	PBDNJ	760,732
7	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	PDIU	609,200
8	Partia Demokristiane e Shqiperise	PDK	560,008
9	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqiperise	PAA	559,503
10	Partia G99	G 99	546,584
11	Levizja per Zhvillim Kombetar	LZHK	452,492
12	Partia Levizja e Legalitetit	PLL	450,725
13	Partia Demokracia Sociale	PDS	437,427
14	Lidhja per Drejtësi dhe Progres	LDP	61,321
15	Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë	PPKDSH	61,321
16	Aleanca Popullore	AP	61,321
17	Partia Mendimi i Djathte Liberal	MDL	61,321
18	Partia e Punes se Shqiperise	PPSH	61,321
19	Ligj dhe Drejtësi	PLiDr	61,321
20	Partia Unitetit Kombetar	PUK	61,321
21	Partia Socialiste e Vërtetë 91	PSV 91	61,321
22	Partia Shqiptare Atdheu	PSHA	61,321
23	Partia Pajtitimit Kombetar	PPK	61,321
24	Partia Komuniste e Shqipërisë	PKSH	61,321



25	Partia e Gjelber	PGJ	61,321
26	Partia e Punes e Shqiperise e Riorganizuar	PPSHR	61,321
27	Partia Bashkimi Republikan Shqiptar	PBR	61,321
28	Partia Rruga e Lirisë	PRRL	61,321
29	Aleanca Arbnore Kombëtare	AAK	61,321
30	Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë	PKDSH	61,321
31	Aleanca per Barazi dhe Drejttesi Europiane	ABDE	61,321
32	Partia Ambientaliste	PA	61,321
33	Partia e Çeshtjeve Shqiptare	PÇSH	61,321
34	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	PRDSH	61,321
35	Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori	PKSH-8 Nëntori	61,321
36	Partia Socialpuntore Shqiptare	PSP	61,321
37	Partia Demokrate per Integrim e Prosperitet	PDIP	61,321
38	Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Emigranteve	PMDE	61,321
39	Levizja per Drejttesi e Shqiptareve	LDSH	61,321
40	Partia Personat me Aftësi të Kufizuar	PPAK	61,320
41	Partia Aleanca Demokristiane e Shqiperise	ADK	61,321
42	Partia Levizja Punetore Shqiptare	PLPSH	61,321
43	Partia Ardhmerija Shqiptare	PASH	61,321
44	Partia Toleranca e Re e Shqiperise	PTR	61,321
45	Partia Socialiste e Moderuar	PSM	61,320
46	Partia Levizja Demokratike per Ndryshim	PLDN	61,321
47	Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet	ADS	61,321
48	Partia Demokracia e Re Europiane	PDRE	61,321
49	Aleanca Demokratike	AD	61,321
50	Partia Emigracioni Shqiptar	PESH	61,321
51	Partia Minoriteti Etnik Grek per te Ardhmen	MEGA	61,321
52	Partia e te Drejtave te Mohuara	PDM	61,321
53	Partia Ora e Shqiperise	POSH	61,321
54	Balli Kombëtar Demokrat	PBKD	61,320
55	Partia e te Drejtave te Mohuara e Re	PDM e Re	61,321
56	Partia Rruga e Vertete Shqiptare	PRVSH	61,321
57	Partia Lëvizja Shqipëria e Re	PLSHR	61,320
58	Partia Balli Kombetar	PBK	61,320
59	Bashkimi Liberal Demokrat	BLD	61,320
60	Partia Bashkimi Popullor i Pensionisteve Shqiptar	PBPPSH	61,320
61	Partia Konservatore	KONS	61,320
62	Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare	LDK	61,320
63	Aleanca e Maqedonasve per Integrim Europian	AMIE	61,320
64	Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar	PBD	61,320

65	Aleanca Kuq e Zi	AK	61,320
66	Fryma e Re Demokratike	FRD	61,320
	Gjithsej		65,000,000

Me shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, fondi prej 65 milionë lekësh u rishpërnda nga KQZ me vendimin nr.767, datë 9.08.2013 "Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që përfitojnë partitë politike të regjistruara si subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23 qershor 2013", si më poshtë:

Rishpërndarja e fondeve, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend 2013			
Nr.	Partite politike	SHKRONJA NISTORE	Shuma totale e perfituar
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	28,660,995
2	Partia Demokratike	PD	21,227,288
3	Levizja Socialiste per Integrim	LSI	7,250,349
4	Partia Republikane Shqiptare	PR	2,095,840
5	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	PSD	410,587
6	Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut	PBDNJ	591,454
7	Partia Drejtasi, Integrim dhe Unitet	PDIU	1,806,139
8	Partia Demokristiane e Shqiperise	PDK	533,843
9	Partia Demokracia Sociale	PDS	477,719
10	Fryma e Re Demokratike	FRD	1,177,524
11	Aleanca Kuq e Zi	AK	409,622
12	Aleanca Popullore	AP	358,641
	Gjithsej		65,000,000

Sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, nga shumat që përfitonin, 3 partive politike (PS, PD, LSI) iu zbrit vlera e gjobës së vendosur si masë administrative me vendim të KQZ-së, për mosrespektim të kuotave gjinore në përgatitjen e listave shumëmemërore të kandidatëve për deputet në Kuvendin e Shqipërisë si edhe shuma e përfituar nga shpërndarja e fondeve paradhënie.

Përveç fondeve publike të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, subjektet zgjedhore, për qëllime të fushatës zgjedhore mund të financohen edhe nga burime të tjera sipas përcaktimeve të nenit 87/1 të Kodit Zgjedhor. Për të gjitha fondet e përfituara si edhe për mënyrën e përdorimit të tyre, subjektet zgjedhore auditohen



nga ekspertë kontabël të licensur, të cilët përzgjidhen dhe emërohen me short nga KQZ.

Me vendim nr. 752, datë 02.08.2013 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin 2013" KQZ përzgjodhi dhe emëroi mbi bazën e rezultatit të shortit të hedhur, 9 ekspertë kontabël të licensuar për auditimin e 68 subjekteve zgjedhore që morën pjesë në zgjedhjet e datës 23 qershor 2013, 66 parti politike dhe 2 kandidatë të pavarur të propozuar nga zgjedhësit.

Dorëzimi pranë KQZ-së i raporteve të auditimit duhej të bëhej 30 ditë nga lidhja e kontratës për secilin ekspert. KQZ administroi raportet e auditimit dhe përgatiti një material mbi bazën e opinionit të shprehur në këto raporte nga ekspertët kontabël. KQZ nuk ka kapacitete të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të bërë verifikime të mëtejshme në lidhje me fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore. Nga dorëzimi i raporteve të auditimit, rezultojnë se:

- Për 7 parti politike nuk ka raporte auditimi, për arsye se ekspertët nuk kanë arritur t'i kontaktojnë;
- 24 parti politike dhe 1 kandidat i pavarur deklarojnë se nuk kanë përfutur dhe nuk kanë shpenzuar fonde për fushatën zgjedhore 2013;

Fondet e shpenzuara nga partitë politike dhe kandidatët e pavarur, të cilët kanë përfutur dhe shpenzuar fonde për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend 2013 janë si më poshtë:

1.	Partia Socialiste e Shqipërisë	187,183,915 leke
2.	Partia Demokratike	96,610,377 leke
3.	Levizja Socialiste për Integrim	47,194,359 leke
4.	Partia Republikane Shqiptare	19,568,576 leke
5.	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	6,920,496 leke
6.	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	6,886,348 leke
7.	Fryma e Re Demokratike	4,182,830 leke
8.	Dritan Prifti	2,478,892 leke
9.	Aleanca Popullore	2,032,474 leke
10.	Aleanca Kuq e Zi	1,722,805 leke
11.	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	1,111,418 leke
12.	Lidhja për Drejtësi dhe Progres	990,535 leke



13.	Levizja per Zhvillim Kombetar	816,174 leke
14.	Partia Demokratike e Shqiperise	747,982 leke
15.	Partia G99	548,800 leke
16.	Partia Lidhja Demokratike Shqiptare	434,000 leke
17.	Partia Shqiptare Atdheu	430,000 leke
18.	Partia Levizja Shqiperia e Re	417,022 leke
19.	Aleanca Demokratike	255,000 leke
20.	Partia Demokracia Sociale	231,045 leke
21.	Partia Komuniste e Shqiperise	229,650 leke
22.	Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet	215,000 leke
23.	Partia Levizja Demokratike per Ndryshim	115,300 leke
24.	Partia Emigracionit Shqiptar	156,921 leke
25.	Partia Ambientaliste	110,000 leke
26.	Partia e Gjelber	108,017 leke
27.	Partia MEGA	96,100 leke
28.	Partia Bashkimi Republikan Shqiptar	82,339 leke
29.	Partia Balli Kombetar	73,000 leke
30.	Bashkimi Liberal Demokrat	71,000 leke
31.	Partia e Reformave Demokratike	68,600 leke
32.	Partia Personat me Aftesi te Kufizuara	66,601 leke
33.	Partia Demokracia e Re Europiane	64,400 leke
34.	Partia Socialiste e Moderuar	62,750 leke
35.	Partia Ora e Shqiperise	61,321 leke
36.	Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqiperise	61,321 leke
37.	Partia Konservative	60,000 leke

Shuma më e madhe që është akorduar nga fondet publike, sipas nenit 87/3 të Kodit Zgjedhor, për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e datës 23 qershor 2013, i është shpërndarë Partisë Socialiste të Shqipërisë, **në vlerën 26,114,596** lekë. Sipas nenit 90, pika 3 të Kodit Zgjedhor, shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike për fushatën zgjedhore, nuk duhet të kalojë 10-fishin e kësaj shume (261,145,960 lekë). Të gjitha partitë politike e kanë zbatuar këtë parashikim ligjor për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin 2013. Partia Socialiste e Shqipërisë, ka shpenzuar shumën më të madhe në krahasim me subjektet e tjera zgjedhore në vlerën 187,183,915 lekë.

Neni 90, pika 3 e Kodit Zgjedhor, parashikon se “çdo shpenzim i kryer për fushatën zgjedhore dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi”.



Ky detyrim ligjor u zbatua përgjithësisht nga subjektet zgjedhore, por në disa raste, eksperti tërheq vëmendjen për moskryerje të shpenzimeve me dokumente të rregullta tatimore, për partitë politike si më poshtë:

Partia Demokratike, për shpenzimet e kryera nga degët në rrethe

Fryma e Re Demokratike, Bamir Topi

Aleanca Kuq e Zi, Kreshnik Spahiu

Partia Aleanca Popullore, Artur Dojaka

Partia Balli Kombëtar, Adriatik Alimadhi

Partia Konservatore, Armando Ruco

Partia Demokracia e Re Europiane, Koci Tahiri

Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Skender Halili

Partia Ambientaliste, Nasi Bozheku

Partia Aleanca Demokratike, Arben Demeti

Partia Lidhja Demokristiane e Shqiperise, Nikoll Lesi

Të gjitha fondet e përfituara nga persona fizik ose juridik, subjektet zgjedhore i kanë regjistruar në regjistrin e posaçëm, miratuar me vendim të KQZ-së. Në çdo rast në çastin e dhurimit është nënshkruar deklarata ku dhuruesi zotohet se nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të Kodit Zgjedhor, dhe mban përgjegjësi personale për deklarim të rreme. Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë është bërë në llogarinë e posaçme të hapur nga subjekti zgjedhor për këtë qëllim. KQZ ka publikuar raportet e auditimit në faqen zyrtare të internetit, brenda afatit që parashikon Kodi Zgjedhor (30 ditë nga dorëzimi i tyre). Lista e donatorëve, që kanë dhuruar shuma mbi 100 mijë lekë, është bërë publike bashkë me raportet e auditimit.



F. ZGJEDHJET E PJESSHME

F.1 ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË QEVERISJES VENDORE TË DATËS 23 QERSHOR 2013

Presidenti i Republikës, dekretoi datën 23 qershor 2013, si datë për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Bulqizë, Kryetar të Komunës Thumanë, Kryetar të Njesisë Bashkiake Nr. 1, Bashkia Tiranë dhe Kryetar të Komunës Sevaster. Këto zgjedhje u zhvilluan në të njëjtën ditë me zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë.

Për këto zgjedhje u shfrytëzuan të njëjtët komisione të niveleve të dyta e të treta të ngritura për zgjedhjet e përgjithshme, si dhe u shfrytëzua e njëjta bazë materiale zgjedhore, listë zgjedhësish dhe dokumentacion zgjedhor. Megjithatë përgatitja e disa prej materialeve zgjedhore për administrim të këtij procesi të pjesshëm zgjedhor, kërkoi vëmendje dhe angazhim të shtuar në një kohë relativisht të shkurtër dhe të ngarkuar.

KQZ, miratoi 19 akte nënligjore për të rregullar procesin për administrimin e njëkohshëm të votimit për dy organe në këto katër KZAZ dhe KQV-të respektive.

Aktet përcaktuan rregulla për radhën e numërimit të votave apo miratimin e modeleve të dokumentacionit që do të përdoren nga GN-ja dhe KZAZ-ja për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve, të datës 23.06.2013 në këto ZAZ. Këto akte të KQZ-së rregulluan veçanërisht procedurën për administrimin e fletës së votimit të hedhur në kutinë e gabuar dhe pasqyrimin e rezultatit në këto raste, procedura të cilat ishin risi në Kodin Zgjedhor.

Në zgjedhjet e pjesshme për kryetar në këto njësi të organeve të qeverisjes vendore, si subjekte zgjedhore u regjistruan gjithsej 9 parti politike dhe dy koalicione zgjedhore.

Numërimi i votave për kryetarët e njësive të pushtetit vendor u zhvillua menjëherë pasi mbaroi numërimi i kutive të votimit në të cilat ishte votuar për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë. Me gjithë specifikat procedurale, numërimi i votave për zgjedhjet e pjesshme u krye korrektësisht, pa dëshmuar problematika. Baza materiale zgjedhore e këtyre zgjedhjeve u dorëzua në KQZ bashkë me bazën materiale zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvend.



F.2 ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË QEVERISJES VENDORE TË DATËS DATË 1 SHTATOR 2013

Presidenti i Republikës, me Dekretet Nr. 8280, datë 31 korrik 2013 dhe Nr. 8283, datë 02.08.2013, caktoi datën 1 shtator 2013 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjeshme për Kryetar të Komunës Dardhas, Qarku Korçë dhe Kryetar të Komunës Rrethina, Qarku Shkodër.

Në këto zgjedhje u regjistruan 5 parti politike dhe dy koalicione zgjedhore. KOZ miratoi 16 akte nënligjore për administrimin e këtij procesi.

KOZ ngriti respektivisht KZAZ-në Nr. 2, Qarku Shkodër dhe KZAZ-në Nr. 73, Qarku Korçë. Selitë e këtyre KZAZ-ve dhe VNV-të respektive u vendosën në Bashkinë Shkodër dhe në Komunën Dardhas. Këto zgjedhje në përgjithësi shkuan të qeta dhe nuk pati kontestime para, gjatë apo pas ditës së zgjedhjeve. KOZ, mori të gjitha masat e nevojshme dhe realizoi trajnimin e KZAZ-ve në veçanti për dokumentacionin e kandidimit dhe punën e KZAZ-së. Trajnimi për anëtarët e qendrave të votimit dhe grupet u numërimi, sërish u "cënua" nga emërimet e vonuara të anëtarëve të KOV. Situata u menaxhua me fleksibilitet duke zhvilluar trajnimin para marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KOV.

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe nuk u paraqitën probleme logjistike apo probleme të tjera të çfarëdo lloji. Procesi i numërimi filloi sapo në KZAZ erdhi edhe baza materiale e qendrës së votimit të fundit.

I efektshmëm dhe rezultativ ishte projekti i KOZ-së për transmetimin e pjesëmarrjes në votime në çdo 3 orë, duke përfshirë edhe komponentin gjinor në këtë raportim. Gjithashtu, u dërguan në kohë reale rezultati i zgjedhjeve për çdo kuti votimi menjëherë pas përfundimit të numërimi.

Në Komunën Dardhas procesi i numërimi përfundoi në më pak se 2 orë për shkak të numrit të vogël të zgjedhësve, ndërsa numërimi në Komunën Rrethina u mbyll në më pak se 6 orë. Gjatë numërimi nuk u paraqit as një problem apo bllokim i procesit.



F.3 ZGJEDHJET E TRETA TË PJESSHME U ZHVILLUAN NË DATË 3 NËNTOR PËR KRYETARIN E BASHKISË KORÇË DHE KRYETARIN E KOMUNËS KARBUNARË, QARKU FIER

Për këto zgjedhje KQZ, ngriti KZAZ-në Nr. 53, Qarku Fier dhe KZAZ-në Nr. 71 Qarku Korçë. Selitë e KZAZ-ve dhe VNV-të për këto njësi të pushtetit vendor u caktuan respektivisht në Bashkinë Lushnje dhe në Bashkinë Korçë.

Në këto zgjedhje u regjistruan 5 parti politike dhe dy koalicione zgjedhore. KQZ miratoi 16 akte nënligjore për administrimin e këtij procesi.

Në procesin para datës së zgjedhjeve u depozitua një ankim zgjedhor kundër vendimeve të KZAZ-së, me objekt ndryshimin e vendimit të KZAZ-së për regjistrimin e kandidatës për Kryetare për Bashkinë Korçë të propozuar nga Partia Fryma e Re Demokratike. KQZ shqyrtoi ankimin dhe vendosi pranimin e tij, mbi bazë të konstatimit se vendimi objekt ankimi ishte në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor. Kundër Vendimit të KQZ-së, Partia Fryma e Re Demokratike bëri ankim në Kolegjin Zgjedhor, i cili rrëzoi kërkesën e FRD-së, duke lënë në fuqi vendimin e KQZ-së.

KQZ mori të gjitha masat për trajnimin e anëtarëve të KZAZ-ve dhe të qendrave të votimit. Për komisionerët e qendrave të votimit trajnimi u planifikua dhe realizua në një periudhë 8 ditore, dhe duke shfrytëzuar 2 ambiente në Bashkinë Korçë: njëri në Bibliotekën e Qytetit, tjetri në sallën e mbedhjeve të Këshillit të Qarkut Korçë. Trajnimet u zhvilluan të rregullta dhe madje u organizuan edhe sesione shtesë gjatë orëve të pasdites apo ditën e shtunë për ato anëtarë të qendrave të votimit të cilët nuk kishin mundësi të ndiqnin trajnimin gjatë orareve të caktuara.

Në kuadër të fushatës edukuese të zgjedhësve, me gjithë kohën e shkurtër në dispozicion, KQZ realizoi informimin publik me anë të reklamave në hapësira publike (City Lights), prodhimin e posterave me përmbajtje dispozitat ligjore të rasteve të veprimeve të komisionerëve në shkelje të ligjit zgjedhor, si dhe sanksionet administrative/penale për çdo rast. Këto postera, së bashku me posterat e tjerë me përmbajtje informuese për veprimet që duhet të kryejë zgjedhësi në qendrën e votimit, çfarë nuk lejohet në qendrën e votimit, u afishuan në çdo qendër votimi.



Duke synuar sensibilizimin e votuesve të rinj, për ushtrimin e të drejtës së votës si detyrë dhe përgjegjësi qytetare u organizua një takim i Kryetares dhe anëtarëve të KQZ-së me studentë dhe nxënës së shkollave të mesme të qytetit në sallën e Universitetit të Korçës. Interesi dhe pjesëmarrja aktive e të rinjve nëpërmjet pyetjeve për aspekte të ndryshme të procesit, ishte dëshmuar më i qartë për përmbushjen e qëllimit të takimit: krijimi i bindjes tek të rinjtë për vlerën dhe forcën e votës së tyre, me qëllim konsolidimin e kulturës që ata do ta bartin gjatë gjithë jetës, pra në shumë procese të tjera zgjedhore: vota është e drejtë, por edhe detyrë!

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe qendrat e votimit u hapën të gjitha në orën 7:00 dhe u mbyllën në ora 18:00. Procedurat në të gjitha qendrat e votimit, të inspektuara gjatë gjithë ditës së votimit, u respektuan dhe komisionerët ishin të qartë për mënyrën e kryerjes së tyre. Mungesa në bazën materiale ditën e zgjedhjeve nuk kishte në asnjë rast.

Në zgjedhjet e 3 nëntorit, sikundër edhe në zgjedhjet e 1 shtatorit, u aplikua projekti për transmetimin e pjesëmarrjes në votime çdo tre orë, përfshirë dhe komponentin gjinor. Por në ndryshim, u aplikua marrja e informacionit nga KQV-ja, një mënyrë kjo më e shpejtë dhe më rezultateve. Vlen të theksohet se në të dyja rastet e aplikimit, projektet rezultuan shumë të suksesshëm dhe gadishmëria e komisionerëve për të dhënë informacionin ishte optimale.

Trajnimimi i anëtarëve të grupeve të numërimit u zhvillua para se të fillonte procesi i numërimit pasi edhe emërimi grupeve të numërimit nga ana e KZAZ-së u bë ditën e zgjedhjeve.

Procesi i numërimit në Korçë filloi rreth orës 23:00 dhe përfundoi rreth orës 6:00 të ditës së nesërme. Numërimi shkoi i qetë dhe pa ndërprerje të procesit apo situata konfliktuale.

Ajo që vlen të përmendet për procesin e numërimit është transmetimi "Live" në internet dhe sallën e transmetimit të rezultateve në KQZ i numërimit të votave për çdo tavolinë numërimi. Ky projekt u realizua me sukses gjatë gjithë procesit të numërimit të votave në të dyja VNV-të dhe siguroi transparencë në kohë reale, brenda dhe jashtë vendit.



G. TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË SË KOZ-SË

Transparenca e veprimtarisë së KOZ-së, për vet misionin që ky institucion përmbush, është një nga garancitë për rritjen e besimit të publikut në procesin zgjedhor. Vecanërisht në një vit zgjedhor, interesimi i publikut dhe medias për aktivitetin e KOZ-së rritet ndjeshëm.

Seancat e mbledhjeve të Komsionit Qendror i Zgjedhjeve janë përherë publike, kanë gjithmonë vëmendjen dhe praninë e medias dhe mund të ndiqen drejtpërsëdrejti nga faqja zyrtare e internetit të KOZ-së. Në kuadër të kësaj transparence, KOZ ka përdorur të gjitha mënyrat e komunikimit për njoftuar rregullisht dhe në kohë, jo vetëm subjektet zgjedhore, por edhe të gjitha mediat e shkruara dhe audiovizive.

Të gjitha njoftimet për mbledhjet e KOZ-së, nuk janë thjesht të karakterit formal për kohën e zhvillimit të tyre, por shoqërohen përherë me dokumentacionin përkatës, objekt shqyrtimi në trendin e ditës. Përgjithësisht, kjo transparencë ndihmoi në mirëinformimin e opinionit publik, por ka patur raste që si rezultat i mosnjohjes apo moskuptimit të ligjit zgjedhor, vendimmarrja e KOZ-së nuk u përcoll në mënyrë të saktë dhe korrekte.


Risi në rritjen e transparencës së veprimtarisë së KOZ-së është fakti se në publikimin e rezultatit paraprak dhe atij përfundimtar, të gjitha mediave, si dhe çdo qytetari të interesuar, iu dha akses direkt nga ekranet e KOZ-së, brenda dhe jashtë ambienteve të saj. Kjo infrastrukturë transparente, nëpërmjet medias, i erdhi në ndihmë të gjithë opinionit publik, pasi ishte vet media që në transmetimin e rezultateve i referoheshin të dhënave zyrtare të pasqyruara nga KOZ.

H. VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KOZ-SË

H.1 BURIMET NJERËZORE NË KOZ


Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ushtruar veprimtarinë e tij funksionale për vitin 2013 me një strukturë organike të përbërë nga 7 anëtarë, 30 nëpunës civilë dhe 18 punonjës mbështetës.





Me synim rritjen e produktivitetit të punës së administratës, si dhe për zbatim të standardeve të përcaktuara në VKM-në VKM-në Nr.474, datë 16.06.2011 "Për përcaktimin e standarteve të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucionit të administratës publike", KQZ kishte prioritet për vitin 2013, ristrukturimin e organikës së administratës.

Pavarësisht vullnetit institucional dhe detyrimit të buruar nga ky akt nënligjor, për shkak të rrethanave të faktit – mungesës së kuorumit, pra pamundësisë së realizimit të vendimmarrjes të cilësuar - çështja e ristrukturimit të administratës së KQZ-së mbetet e hapur për t'u realizuar në momentin më të parë të plotësisht të trupës së KQZ-së.




Për vitin raportues një nga orientimet kryesore të punës së institucionit ka qenë dhe rritja e profesionalizmit së administratës së përhershme të saj, emërimet dhe rekrutimet për pozicione pune të krijuara të lira, bazuar në procedura transparente nëpërmjet zbatimit korrekt të kuadrit ligjor të nëpunësit civil.

Gjatë kësaj periudhe, trajnime të administratës zgjedhore në bashkëpunim me Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike apo edhe me organizatat ndërkombëtare kanë qenë të reduktuara krahasur me vitin pararendës, për shkak të volumit të punës që mbart një vit zgjedhor. Referuar impaktit pozitiv që sjell trajnimi i administratës zgjedhore në funksion të kualifikimit dhe ngritjes së nivelit profesional për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, mbetet detyrë për të ardhmen gjetja e mekanizmave gjithëpërfshirës për trajnimin specifik të administratës. Aktualisht, KQZ është duke ndërtuar një strategji të qartë nëpërmjet projekteve të paraqitura partnerëve ndërkombëtarë që operojnë në fushën e zgjedhjeve për të mundësuar




vlërësimin e kapaciteteve profesionale aktuale të administratës së KOZ-së dhe nevojat specifike të rritjes së këtyre kapaciteteve.

Pas miratimit të strukturës së personelit shtesë nga KOZ, me Vendimin nr.21, datë 21.12.2012 “Për miratimin e strukturës së personelit shtesë të KOZ-së, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23.06.2013”, menjëherë filluan për procedurat për rekrutimin e stafit të përkohshëm. Procedurat e përzgjedhjes së personelit të përkohshëm, u kryen nëpërmjet një grupi pune, dhe më pas, të gjithë të rekrutuarit u trajnuan sipas fushave specifike ku u angazhuan. Për zgjedhjet për Kuvend 2013 janë punësuar gjithsej 257 punonjës, nga të cilët 91 Nd/Specialistë, 24 Inspektor Rajonalë dhe 142 punonjës mbështetës.



Në një vit zgjedhor, institucioni i KOZ-së duhet të administrojë një korrespondencë, e cila përfshin një gamë dhe intensitet shkëmbimi informacioni jashtëzakonisht të shtuar. Është fakt që ky proces është realizuar në kohë, me cilësi, transparencë dhe etikë si ndaj administratës zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, ashtu edhe ndaj subjekteve zgjedhore, ministrive dhe institucioneve të tjera, qendrore apo vendore, shoqërisë civile, partnerëve ndërkombëtarë, etj.

Të gjitha vendimet dhe udhëzimet e KOZ-së, si në projekt dhe pas miratimit, janë publikuar në kohë reale në faqen zyrtare të KOZ-së, sikundër dhe u janë shpërndarë edhe përfaqësuesve të subjekteve politike, partnerëve monitorues dhe subjekteve të tjera të interesuar.



Me të njëjtin profesionalizëm është administruar dokumentacioni edhe në periudhën pas ditës së zgjedhjeve, i cili përfshin dorëzimin e tabelave të rezultateve të Qendrave të Votimit, Tabelat e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve nga KZAZ-ja, si dhe dokumentacionin e punës të administruar nga KZAZ-të përkatëse. Vlen për t'u thkesuar se për herë të parë, dokumentacioni i çështjeve në gjykim nga Kolegji Zgjedhor është vënë në dispozicion menjëherë pas marrjes së njoftimit. Fakti që ky



dokumentacion u vu paraprakisht në dispozicion, i dha mundësi Kolegjit Zgjedhor që të njihet në kohë me tërësinë e provave të administruara gjatë shqyrtimit administrativ nga KQZ.

Si pjesë e këtij volumi të madh pune, vlen për t'u evidentuar procesi i zbardhjes së procesverbaleve të mbledhjeve të KQZ-së për miratimin e 853 vendimeve dhe 4 udhëzimeve, pjesë e të cilave janë edhe ato të përdorura si provë në Kolegjin Zgjedhor.

Mungesa e kushteve teknike mbetet problem për t'u referuar dhe zgjidhur, në funksion të ruajtjes së dokumentacionit në Zyrën e Arkivës: mjete mbrojtëse nga zjarri, pluhuri, dëmtuesit fizikë e biologjikë si dhe lagështia mbi nivelin e përcaktuar në nenin 106, të rregullores "Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", në mbështetje të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".

Edhe pse në një periudhë kohore mjaft të ngjeshur, u realizuan të gjitha procedurat prokurorese dhe u sigurua e gjithë baza logjistike zgjedhore, materialet informuese, edukuese dhe sensibilizuese për zgjedhësit, të cilat ndihmuan drejtpërdrejtë në rritjen e performancës së KQZ-së në këto zgjedhje.

H.2 BUXHETI I KQZ-SË PËR VITIN 2013


Për vitin 2013, KQZ-së iu vu në dispozicion 123,000 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim dhe administrim" për shpenzimet e administratës për paga dhe sigurime, shpenzime për mallra dhe shërbime si edhe për shpenzime kapitale.

Në zbatim të ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar, si edhe me kërkesë të KQZ-së, Ministria e Financave vuri në dispozicion shumën e nevojshme për shpërblimin në masën që përcakton ligji për katër anëtarët e KQZ-së, të cilët u liruan nga detyra me vendimet përkatëse të Kuvendit të Shqipërisë.



Buxheti i institucionit per vitin 2013							
-	<u>600</u>	<u>601</u>	<u>602</u>	<u>604</u>	<u>606</u>	<u>231</u>	<u>Totali</u>
buxheti fillestar	64,300,000	7,700,000	17,880,000		3,120,000	30,000,000	123,000,000
ndryshimet	-7,000,000		65,000	696,650			
			-2,000,000				-1,238,350
			7,000,000				
buxheti final	57,300,000	7,700,000	22,945,000	696,650	3,120,000	30,000,000	121,761,650

Në zbatim të buxhetit të akorduar u realizuan procedurat prokuruese për sigurimin e bazës materiale për funksionimin e institucionit, konform kuadrit ligjor për prokurimet publike.



H.3 RAPORTET FINANCIARE VJETORE TE PARTIVE POLITIKE PER VITIN 2012

Ligji nr.10374, datë 10.02.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar", në nenin 23, parashikon se partitë politike duhet të dorëzojnë raportet financiare (bilancin vjetor) në KQZ për vitin pararendës. Me vendim të KQZ-së, afati i dorëzimit të këtij raporti, është caktuar data 31 mars e vitit pasardhës.

Modeli i këtij raporti, në zbatim të ligjit të sipërcituar, (neni 15/2), është miratuar me vendimin e KQZ-së nr.3, datë 18.01.2012 "Për miratimin e rregullave për formatet e standartizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar të ekspertëve kontabël".

Për vitin kalendarik 2012, nga 123 parti politike të regjistruara në gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë dhe që kishin detyrimin ligjor për të dorëzuar raportet financiare



vjetore në KQZ deri më datë 31 Mars 2013, vetëm 7 parti politike kanë plotësuar këtë detyrim: Partia Demokratike, Partia Socialiste e Shqipërisë, Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Republikane Shqiptare, Partia për Drejtesi, Integrim dhe Unitet, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Socialdemokrate dhe Aleanca Kuq e Zi. Pavarësisht këtij fakti, me qëllim auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2012, KQZ me vendimin nr.504, datë 03.06.2013 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël që do të auditojnë fondet e partive për vitin 2012", përzgjodhi me short dhe emëroi 19 ekspertë kontabël të licensuar për auditimin e 123 partive politike të regjistruara në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga të cilët u paraqitën pranë KQZ-së për të lidhur kontratën e shërbimit vetëm 9 ekspertë kontabël.

Në përfundim të procesit të auditimit, nga 123 parti politike të regjistruara në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vitin kalendarik 2012, janë paraqitur raporte auditimi nga ekspertët kontabël vetëm për 13 parti politike. Me 21 parti politike ekspertët nuk kanë arritur të kontaktojnë, ndërsa për 89 parti politike nuk ka informacion në lidhje me financimet vjetore 2012.

I. BASHKËPUNIMI I KQZ-SË ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË

Bashkëpunimi permanent me partnerët ndërkombëtarë si dhe përfaqësitë diplomatike në Tiranë, ka qenë një mbështetje e madhe në punën e KQZ-së. I gjithë faktori ndërkombëtar që ka asistuar dhe monitoruar punën e KQZ-së, dëshmoi edhe në këtë proces zgjedhor interesin për realizimin e një procesi zgjedhor të lirë, të ndershëm dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Me iniciativë dhe koordinim të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, në muajin nëntor 2012 është ngritur dhe mbledhur rregullisht në vijimësi **Election Working Group**. Ky grup përbëhet nga ambasadat e shteteve që janë anëtare të OSBE-së dhe Organizatat Ndërkombëtare prezente në Shqipëri, të cilat kanë pjesë të aktivitetit të tyre edhe fushën zgjedhore. Qëllimi ishte konsultimi në dinamikë me veprimtarinë e KQZ-së dhe koordinimi i projekteve dhe asistencës teknike që iu ofrua KQZ-së në funksion të rritjes së performancës dhe përmirësimit të infrastrukturës teknike zgjedhore. Duke parë intensitetin e aktiviteteve post zgjedhore dhe interesin reciprok



për të evidentuar problemet dhe përmirësimet e nevojshme në infrastrukturën dhe administratën zgjedhore, funksionimi i këtij grupimi vazhdon edhe sot të jetë aktiv dhe me një interes të shtuar në projekte zhvillimi, për t'u përgatitur në kohë për zgjedhjet e ardhshme dhe për të shmangur zgjidhjet e momentit të fundit.

Për t'iu kthyer mbështetjes dhe asistencës teknike të partnerëve ndërkombëtarë, pikënisja e këtij bashkëpunimi ka qenë realizimi nga Qendra Ndërkombëtare për Studime Parlamentare i kursit të trajnimit të çertifikuar për trupën e KQZ-së dhe një pjesë të administratës së saj, në lidhje me të gjitha fazat e menaxhimit të procesit zgjedhor, problematikat dhe sfidat e tij. Ballafaqimi i praktikave të ndryshme zgjedhore, ishte një ndihmesë e madhe për trupën e re të KQZ-së, e cila shërbeu në aktivitetin dhe veprimtarinë e mëpasshme të KQZ-së. Ky ishte një nga aktivitetet e nivelit më të lartë që organizohen në nivel ndërkombëtar me profesionistët e administrimit të proceseve zgjedhore dhe u mbështet nga disa donatorë, si OSBE, KiE, UN Women, Ambasada e Britanisë së Madhe, etj.

Në nivelin e ndihmës teknike ligjore, Zyra e Këshillit të Evropës atashoi pranë KQZ-së dy ekspertë të mirënjohur të Komisionit të Venecias, të cilët u fokusuan respektivisht në dy fusha bazë: i. përgatitja e projekt-rregullores të organizimit dhe funksionimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; dhe ii. përgatitja e moduleve të trajnimit të të gjitha niveleve të administratës zgjedhore. Rezultati pozitiv i manualeve të trajnimit në formimin profesional të administratës zgjedhore, është shpjeguar gjerësisht në hapësirat përkatëse të këtij raporti. Për sa i përket projekt-rregullores së KQZ-së, pavarësisht përgatitjes së një projekti voluminoz dhe të detajuar, si dhe kohës së kushtuar në disa seanca të gjata shqyrtimi në mbledhje të KQZ-së, finalizimi/miratimi i këtij akti nuk përfundoi, për shkak të dorëheqjes së 4 (katër) anëtarëve të KQZ-së nga detyra.

Në nivelin e ndihmës teknike për ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës zgjedhore, mbështetja financiare dhe logjistike ka konsistuar kryesisht në ngritjen e një sistemi të kompletuar në pajisje dhe programim të administrimit të informacionit zgjedhor në tërësi.

Më konkretisht, me mbështetjen e Agjencisë Turke për Kooperimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar, TIKA (Turkish International Cooperation and Coordination Agency) u ngrit rrjeti dhe sistemi fizik i qendrës së të dhënave të KQZ-



së, i cili ishte shumë i vjetëruar dhe jashtë parametrave teknikë që kërkonte aplikimi i programit të administrimit të të dhënave. Ngritja e kësaj infrastrukture konsistonte në: ndërtim rrjeti, servera, kompjutera të nivelit administrator, kompjutera të nivelit operator, operatorët, fotokopje dhe sistem vëzhgimi me kamera.

Ndërtimi i kësaj infrastrukture u përdor dhe do të përdoret në vazhdimësi për ngritjen dhe aplikimin e "Sistemit të Integruar të Administrimit të Informacionit Zgjedhor". Ky projekt madhor që ka nisur të ndërtohet dhe aplikohet për herë të parë nga KOZ, me mbështetjen e USAD dhe implementim të IFES, synon të administrojë në funksion të mirëmanaxhimit dhe transparencës së zgjedhjeve të gjithë informacion zgjedhor. Ashtu siç edhe është theksuar në pjesën e "rezultatit paraprak" të këtij raporti, deri në këtë moment, IFES, në bashkëpunim me KOZ-në, ka arritur të implementojë vetëm pjesën më të rëndësishme të moduleve për zgjedhjet e vitit 2013. Megjithatë, interesi për kompletimin e këtij sistemi është reciprok dhe po shqyrtohen mundësi reale të mbështetjes financiare të tij deri në realizimin përfundimtar të projektit.

Impakti dhe rëndësia e aplikimit të një pjese të projektit të "Sistemit të Integruar të Administrimit të Informacionit Zgjedhor", ishte shfaqja pothuajse në kohë reale e rezultateve të zgjedhjeve, i cili dha mundësinë e informimit të shpejtë dhe transparent të publikut me rezultatet e zgjedhjeve.

Megjithëse një vit zgjedhor, KOZ nuk ka lënë jashtë vëmendjes shkëmbimin e vizitave studimore. Këto vizita konsistojnë në shkëmbimin e përvojave të vendeve të ndryshme, me qëllim ngritjen e standardeve zgjedhore në funksion të rritjes së efikasitetit të punës institucionale dhe modernizimit të të gjithë aspekteve të organizimit, menaxhimit dhe administrimit të zgjedhjeve. Në këtë kuadër, u ri-aktivizua prezenca e KOZ-së në mekanizma ndërkombëtar zgjedhor si ACEEEO (ku Shqipëria është një prej gjashtë anëtarëve themelues të shoqatës në vitin 1991) dhe pjesëmarrja në A-ËEB, Shoqata e Administratorëve Zgjedhorë Botërore- të cilat mbështesin organizmat zgjedhorë në forcimin e profesionalizmin të tyre.

Në vazhden e traditës disa vjeçare të shkëmbimit të eksperiencës në zhvillimin e procesve zgjedhore, respektivisht në Shqipëri dhe Kosovë, jemi në finalizim të një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve homologe të ngarkuara me organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve. Shtyrë nga faktorë specifikë (gjuha dhe kultura e përbashkët), kjo marrëveshje bashkëpunimi, do të kontribuojë në përmirësimin e veprimtarive të dy institucioneve për organizimin dhe administrimin e



zgjedhjeve, si dhe në rritjen e kulturës së bashkëpunimit në fusha me interes të ndërsjellë që lidhen me çështjet zgjedhore.

I gjithë angazhimi dhe bashkëpunimi i partnerëve dhe organizatave ndërkombëtare, kanë shënuar ngritjen profesionale të insitucionit të KQZ-së dhe standardin e zgjedhjeve të vitit 2013, të cilat u nënvizuan shumë qartë edhe në raportet e misioneve të monitorimit, vendase dhe ndërkombëtare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke qenë i ndërgjegjshëm për sfidat që një proces zgjedhor mbart, ka analizuar me shumë seriozitet çdo moment të punës së tij, bazuar edhe në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet për Kuvend të datës 23 qershor 2013.

Kjo analizë intensive dy-ditore, në prezencë të përfaqësuesve të OSBE-së, KiE dhe partive politike me status të përhershëm në KQZ, qartësoi nevojën për ndryshime dhe përmirësime, si të anës legjislative, kryesisht të Kodit Zgjedhor, ashtu edhe të anës organizative të vet KQZ-së.

Problemet më sensitive dhe prioritare njëkohësisht, KQZ po synon t'i kthejë në tryeza teknike pune, me prezencën dhe kontributin e grupeve të interesit, me qëllim ngritjen e një debati thjesht teknik, i cili synon që në përfundim të tij të sjellë një paketë rekomanduese për reformën e pritshme zgjedhore.

Realizimi i kësaj veprimtarie, do të ishte e pamundur pa mbështjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë, për të cilët KQZ gjen rastin të shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen institucionale.

